Programi mësimor i lëndës

“GJYKIME SPECIFIKE”

MODULI 3: MOSMARRËVESHJET TREGTARE

Viti akademik 2026–2027

Për Shkollën e Magjistraturës

Viti akademik 2026 - 2027

(Për vitin e parë të Formimit Fillestar të kandidatëve për ndihmës ligjor)

Pedagogu titullar: Dr. Artan Hajdari

Pedagog të jashtëm, gjyqtar: Alma Kodraliu, Alma Hicka

Pedagog për pjësën e falimentit: Vangjel Kosta

Tabela e përmbajtjes

1. Kuadri i përgjithshëm 3

1.1. Përshkrimi i kursit 3

2. Aftësitë dhe kompetencat.....3

3.1. Objektivat mësimore.....4

3.2. Vlerësim/krijim - Aftësimi për shkrim arsyetim ligjor 4

4. Përmbajtja e kursit.....6

4.1. Struktura dhe metodologjia..... 7

5. Vlerësimi i kursit..... 44

6.Ngarkesa studimore dhe mësimore..... 44

1. Kuadri i Përgjithshëm

1.1.Përshkrimi i kursit

Lënda e "GJYKIMI TREGTAR DHE KOMPANIVE" bënë pjesë në modulin e 3 -të të lëndës së Gjykimeve të Specilizuara, dhe është një nga disiplinat e lëndëve të programit mësimor, të Shkollës së Magjistraturës. Ajo është një nga grup lëndët me shtrirje simestrale.

Lënda në tërësinë e vetë, përmban rregulla të një natyre juridike të veçantë që mbrojnë dhe përcaktojnë natyrën juridike kryesisht të funksionit të brendshëm por edhe atij të jashtëm të shoqërive tregtare.

Gjykimi Tregtar dhe Kompanive, është një dege relativisht e re në sistemin e së drejtës private dhe rregullohet para së gjithash nga rregulla të përcaktuara në ligjin e posaçëm nr. 9901/2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, ligji nr. 110/2016, "Për falimentin", si dhe rregulla të tjera të posaçme të ligjeve të ndryshme organike në fushën e së drejtës private, si Kodi Civil, Kodi i Familjes, Kodi i Punës, Kodi i Procedurës Civile, ligjeve të ndryshme specifike në fushën e sipërmarrjeve private dhe biznesit etj.

Gjykimi Tregtar dhe Kompanive, si pjesë e modulit 3 të Gjykimieve të Specializuara, nëpërmjet zhvillimit praktik të programit do të aftësojë ndihmësat ligjore në një program të veçantë për punën e tyre të ardhëshme, në ndihmë të gjyqtarëve pranë të cilëve do punojnë, për zgjidhjen e konflikteve me natyrë tregtare

2. Aftësitë/kompetencat.

Në vijim do të parashtrohen aftësitë/kompetencat si dhe objektivat respektive të lidhura me ato që synohen të arrihen për ndihmësat ligjore, në përfundimin të këtij moduli.
Në përfundim të kursit ndihmësit ligjorë do të jetë në gjendje që, nën mbikëqyrjen minimale dhe brenda një afati kohor të arsyeshëm, të marrë dhe të studiojë faktet dhe rrethanat e çdo rasti praktik me natyrë tregtare, të fokusohet në faktet kyçe ose përcaktuese për zgjidhjen e një rasti konkret të praktikës gjyqësore:

2.1.Të njohë kornizën ligjore të zbatueshme për çdo rast konkret, të arrijë në zgjidhjen dhe argumentimin ligjor të zgjidhjes së rastit praktik.

2.2.Të përpilojë një opnion/relacion/draft akt të strukturuar logjikisht dhe të arsyetuar juridikisht në një çështje me natyrë tregtare që, sipas nivelit faktik/ligjor të vështirësisë, dhe që do të ndihmojë gjyqtarin në punën e tij të përditëshme.

2.3.Ky objektiv zbërthehet më poshtë në objektiva të detajuar mësimorë, të cilët përcaktojnë temat që do të trajtohen në modulin përkatës, metodologjinë e mësimdhënies, ngarkesën e kandidatit për ndihmës ligjorë (ngarkesën studimore) dhe ngarkesën e pedagogut (ngarkesën mësimore).

3. KURSI

3.1 Objektivat mësimore

Për të arritur objektivin kryesor (shih 2.1., 2.2. e 2.3.), kursi synon të arrijë objektivat konkrete mësimore që janë listuar si më poshtë në program.

Në mënyrë skematike, objektivat mësimore synojnë të aftësojnë kandidatët për ndihmësa ligjorë në drejtimet sipas strukturës, si më poshtë:

a. **Kuptimi - Aftësimi në mënyrën e të kuptuarit:** Kandidati për ndihmës ligjorë, është në gjendje të kuptojë, shpjegojë, identifikojë, klasifikojë dhe diskutojë konceptet, parimet dhe institutet e të Drejtës Tregtare dhe të Kompanive që nevojiten për krijimin për punën e tij për zgjidhjen e konflikteve me natyre tregtare.

b. **Zbatimi - Aftësimi në zbatim:** Kandidatët për ndihmësa ligjorë, janë në gjendje të përdorë njohuritë teorike mbi konceptet, parimet dhe institutet kryesore të të drejtës tregtare dhe të kompanive në situata faktike. Në përfundim të kursit, ai është në gjendje të:

-interpretojë konceptet, parimet dhe institutet kryesore të të drejtës tregtare dhe të kompanive bazuar në faktet e një situate tregtare praktike;

-organizojë dhe planifikojë hapat që duhen ndërmarrë për zgjidhjen e një konflikti me natyre tregtare duke u bazuar në njohuritë teorike dhe faktet e çështjes;

-debatojë dhe respektojë mendimet ndryshe të kolegëve, të dhe funksionojë në grup.

c. Analizë - Aftësimi në analizën. Kandidati për ndihmës ligjorë është në gjendje të:

- identifikojë faktet relevante dhe të analizojë kornizat ligjore dhe të formojë një opinion të bazuar në të gjitha të dhënat relevante. Në përfundim të kursit, ai/ajo është në gjendje të:

-identifikojë dhe përzgjedhë detajet përkatëse për pasqyrimin saktë të fakteve të një çështjeje me natyre tregtare konkrete;

-përcaktojë kuadrin ligjor dhe atë statutor të nevojshëm për zgjidhjen e një konflikti me natyre tregtare;

-përcaktojë/evidentojë faktet relevante dhe të zbatojë ligjin për këto fakte, duke marrë parasysh rrethanat në rastin konkret;

-analizojë kontekstin social dhe ndikimin e tij në zgjidhjen e konfliktit.

3.2.Vlerësim/krijim - Aftësimi për shkrim arsyetim ligjor. Kandidati për ndihmës ligjorë është në gjendje të shprehë opinionin e tij qartë në një relacion/opinion apo projekt akt të kërkuar nga gjyqtari, për një rastë praktik me natyrë tregtare, në mënyrë të arsyetuar dhe argumentuar. Në përfundim të kursit, kandidati është në gjendje të:

- ndërtojë logjikisht një relacion/opinion në një konflikt me natyrë tregtare;
- arsyetojë me shkrim relacionin/opinionin
- japë një opinion juridikisht të saktë dhe të arsyetuar në një konflikt me natyre tregtare;
- formulojë shkurt dhe në mënyrë konçize argumentet materialë dhe analizen ligjore që çuan në përgatitjen e relacionit/opinionit ligjor të kërkuar nga gjyqtari.

Objektivat e mësipërme i aftësojnë ndihmësat ligjorë në kompetencat si vijojnë:

Kompetenca 1: Kuptimi - Aftësimi në mënyrën e të kuptuarit:

- është në gjendje të kuptojë, identifikojë, shpjegojë, dhe të zotërojë njohuri të qarta dhe të thelluara teorike mbi konceptet, parimet dhe institutet kryesore, në të drejtën tregtare dhe kompanive, të ndërthurura me aspektin praktik, duke identifikuar dallimet midis instituteve në fushat e ndryshme të së drejtës.
-Të njohë dhe të vlerësojë në mënyrë të thelluar qëndrimet dhe interpretimet me vlerë doktrinore në praktikën gjyqësore brenda vendit dhe të ndjekë jurisprudencën europiane të zbatueshme për kontekstin shqiptar (GJEDNJ, GJED etj).
-të identifikojë çështjet ligjore që ngrihen në një situatë faktike, të përcaktojë bazën ligjore të saj dhe të identifikojë dhe të jetë i vetëdijshëm për synimet legjislative.

Kompetenca 2: Aftësimi në zbatim:

- Të studiojë dosjen/materialin për të përcaktuar natyrën e konfliktit/ngjarjes/çështjes, faktet kyçe, si dhe bazën ligjore përkatëse (ligjin, praktikën gjyqësore, doktrinën, politikat gjyqësore);
- Të përcaktojë kontekstin social të çështjes.

Kompetenca 3: Aftësimi në analizë.
- Është në gjëndje që të përmbledhë dhe anlizojë në mënyrë të saktë dhe të shtrojë pyetje për të kontrolluar kufijtë e kuptimit të çështjes, për të marrë informacionin që i mungon ose është i paqartë për fakte dhe këndvështrime me rëndësi për gjykimin duke ndërtuar strategjinë e pyetjeve dhe ballafaqimeve për të sqaruar mospërputhjet.

Kompetenca 4: Aftësim në përgatitjen e akteve.
- Të vlerësojë kompetencën dhe pranueshmërinë në çështjet me natyre tregtare;
- Të përcaktojë dhe të vlerësojë faktet thelbësore të çështjes, me ndikim në përgatitjen e akteve dhe në marrjen e vendimit, në raport me kontekstin shoqëror të çështjes;
- Të shprehet qartë dhe saktë, me një gjuhë të përshtatshme dhe të kuptueshme për gjyqtarin;
- Të dëgjojë, reagojë dhe komentojë në mënyrë efektive e konstruktive idetë e shprehura nga gjyqtari dhe kolegët, brenda kohës së caktuar, duke propozuar ndryshimet që i çmon të nevojshme, të mbrojë pikëpamjen e tij/saj me vendosmëri dhe, kur është e nevojshme, të heqë dorë prej saj;
- Të përcaktojë, debatojë dhe zbatojë ligjin material, jurisprudencën dhe doktrinën në çështjen konkrete;
- Të analizojë provat, të arsyetojë drejt lidhur me faktet që ato provojnë dhe të dallojë qartë pretendimet/pikëpamjet e paraqitura nga palët nga faktet mbi të cilat bazon opinionin/relacionin e kërkuar nga gjyqtari.
- Të aftësohet për përgatitjen e një opnioni/relacioni apo draft akti të strukturuar dhe të argumentuar qartë duke u mbështetur në përfundimet e arritura, lidhur me çështjet e faktit dhe të ligjit;
- Të tregojë qëndrim të paanshëm dhe me integritet dhe të ketë qëndrim profesional të pavarur për të përballuar presionet e çdo lloji;
- Të aftësohet nën konkluzionet e arritura në çështjen tregtare konkrete duke pasur në vëmendje efektin shoqëror të saj;

- Të familjarizohet shpejt me njohuritë ligjore dhe të analizojë cilat rrethana të tjera mund të ndikojnë në argumentin e opinionit/relacionit apo draft aktit të përgatitur prej tij dhe të marrë parasysh politikat dhe ligjin;
- Të gjejë dhe argumentojë politikën përkatëse në një çështje konkrete.

Kompetenca 5: Forcim i vetëdijes shoqërore të ndihmësit ligjor, integritetit dhe etikës profesionale.

- Të ketë sjellje etike profesionale dhe t'i shmanget konfliktit të interesit në çështjen konkrete;
- Të aftësohet në argumentimin e pavarur në çështjen konkrete me natyre tregtare duke pasur në vëmendje efektin/pasojat ekonomike dhe juridike të veprimtarisë së shoqërive tregtare dhe të palëve të treta.

Kompetenca 6: Bashkëpunimi, transparenca dhe komunikimi

- Të jetë transparent duke respektuar diversitetin, konfidencialitetin dhe parimet e mbrojtjes së të dhënave personale;
- Të komunikojë me një gjuhë të qartë e të përshtatshme dhe të hapur me kolegët, të dëgjojë opinionet e kundërta, të jetë mendjehapur dhe të reflektojë mbi kritikën që i bëhet.

4. PËRMBAJTJA E KURSIT

Në kursin "Gjykimi Tregtar dhe Kompanive", në modulin që do zhvillohët për ndihmësat ligjorë, do të trajtohen çështje të praktikës gjyqësore të cilat do të synojnë që të aftësojnë formimin praktik të tij ose saj në interpretimin ligjor dhe statutor dhe në zgjidhjen sa më të drejtë të çështjeve me natyrë tregtare.

Kursi do të zhvillohet sipas programit gjithsej në 20 orë mësimore.

Temat që do të trajtohen në kursin "Gjykimi Tregtar dhe Kompanive" janë si vijojnë:

1. Dallimi midis Tregtari, Shoqërisë së Thjeshtë dhe Shoqërisë Tregtare. Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit. Personaliteti juridik i këtyre entiteve dhe paditë gjyqësore që lidhen me këto palë (2 orë mësimore).
2. Natyra juridike e kuotës. Paditë gjyqësore që mbrojnë të drejtat që rrjedhin nga kuota (3 orë mësimore).
3. Natyra juridike e funksionit të brendshëm të shoqërisë. Paditë gjyqësore që lidhen më kundërshtimin e akteve të organeve të shoqërisë tregtare (3 orë mësimore).
4. Paditë që lidhen me largimin dhe përjashtimin e ortakut. Paditë e ortaku/shoqërisë që lidhen më likujdimin e kuotës dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e largimit/përjashtimit (3 orë mësimore).
5. Prishja dhe likujdimi shoqërive tregtare. Paditë që lidhen me shkaqet e prishjes së shoqërisë (2 orë mësimore).
6. Natyra e raportit mes shoqërisë dhe administratorit. Paditë që lidhen më shpërbimin financiar të adminitratorit (2 orë mësimore)
7. Falimenti (5 orë mësimore).

4.1.Struktura dhe Metodologjia.

Në këtë seksion zbërthehet struktura dhe përmbajtja e kursit për çdo temë duke ndaluar fillimisht në skemën e kalendarit për temat përkatëse për vitin akademik 2026-2027, në vijim do të zbërthehet përmbajtja për secilën temë.

4.1.1 Struktura e Kursit.

Zbërthimi i kursit të Gjykimit Tregtar dhe Kompanive, për secilën nga temat, si më poshtë:

Tema 1: Dallimi midis Tregtarit, Shoqërisë së Thjeshtë dhe Shoqërisë Tregtare. Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit. Personaliteti juridik i këtyre entiteve dhe paditë gjyqësore që lidhen me këto palë (2 orë mësimore).

Përshkrimi i temës: Në këtë temë për 2 orë mësimore do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë më parime të përgjithshme të së drejtës tregtare dhe kompanive, duke filluar nga fitimi i personalitetit juridik të shoqërisë tregtare si dhe rëndësia që kanë normat ligjore dhe ato statutore në fitimin e këtij personaliteti dhe aftësia e shoqërisë për të qenë palë paditëse ose e paditur në një gjykim me natyrë tregtare. Do të trajtohen çështjet praktike që kostituojnë ”Degën” e shoqërisë tregtare dhe “Zyren e përfaëasimit” duke përcaktuar “personalitetin” të tyre për të qenë ose jo palë në gjykim. Do të trajtohen çështje ligjore që përcaktojnë “Tregtarin” si person fizik që ushtron një veprimtari tregtare dhe paraqitet si palë në një gjykim civil me natyre tregtare.

Tema 2: **Natyra juridike e kuotës/aksionit. Paditë gjyqësore që mbrojnë të drejtat që rrjedhin nga kuota/aksioni (3 orë mësimore).**

Përshkrimi i temës : Në këtë temë të kursit në 3 orë mësimore**,** do të trajtohen çështjet që lidhen me natyrën juridike të kuotës dhe aksionit si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre: të drejtat politike, të drejtat financiare dhe të drejtat pasurore. Po kështu do të trajtohen çështje që lidhen me mënyrat e fitimit dhe transferimit të kuotës dhe veçanërisht kuptimi praktik i padive për mbrojtën e të drejtave të ortakëve/aksionerëve që shkaktohen nga cenimi i interesave pasuror të kuotës/aksionit. Gjithashtu do të trajtohen çështje që lidhen me paditë për pjesëtimin e kuotës/aksionit. Natyra e vendimit të fazës së parë dhe të fazës së dytë të pjesëtimit.

Tema 3 : Natyra juridike e funksionit të brendshëm të shoqërisë. Paditë gjyqësore që lidhen më kundërshtimin e akteve të organeve të shoqërisë tregtare (3 orë mësimore).

Përshkrimi i temës : Në këtë temë të krusit në 3 orët mësimore do të trajtohen çështje të natyrës praktike që kanë të bëjnë me përcaktimin e natyrës juridike të akteve të vullnetit të organeve të shoqërisë tregtare, në funksionin/veprimtarinë e tyre të brendshëm. Natyra e pavlefshmërisë së këtyre akteve, si ajo relative dhe ajo absolute, si dhe analiza praktike, se nga cili rregull udhëhiqet analiza ligjore për të dyja llojet e pavlefshmërisë si dhe zgjidhja e pasojave juridike të këtyre pavlefshmërive. Të përbashkëtat dhe dallimi nga pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën civile. Kontrolli i brendshëm i vendimeve të organeve të shoqërisë si dhe paditë që lidhen më kontrollin gjyqësor të vendimeve të tyre.

***Tema* 4 *:* Paditë që lidhen me largimin dhe përjashtimin e ortakut. Paditë e ortakut/shoqërisë që lidhen më likujdimin e kuotës dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e largimit/përjashtimit (3 orë mësimore).**

Përshkrimi i temës : Në këtë temë në 3 orë mësimore do të trajtohen çështje me rëndësi praktike që lidhen me interpretimin e nenit 101 dhe 102 të LSHT, konkretisht, largimi i ortakëve në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar – natyra juridike e vendimmarrjes. Shkaqet e largimit. Procedura e brendshme. Largimi me marrëveshje/pëlqim të ortakëve, metodat që njeh doktrina dhe praktika për likuidimin të kuotës. Likuidimi i kuotës nga ana e vetë shoqërisë. Padia e ortakut për likuidimin e kuotës. Natyra e padisë dhe çështje të legjitimimit aktiv dhe pasiv. Dëmshpërblimi i ortakut të larguar ndaj shoqërisë dhe padia e ortakut për largimin nga shoqëria dhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar. Momenti i fuqisë juridike të largimit dhe raporti me publikimin e ndryshimeve në QKB. Likuidimi i kuotës së ortakut që përjashtohet. Problemet ligjore, teoritë lidhur me likuidimin e kuotës së ortakut që përjashtohet dhe praktika gjyqësore. Kriteret që mbahen parasysh lidhur me vlerësimin e kuotës. Po kështu do të trajtohen çështje praktike që lidhen me, çështje të përjashtimit të ortakut si koncept i ri në të drejtën e shoqërive tregtare. Kuptimi i përjashtimit të ortakut. Shkaqet dhe kriteret e përjashtimit të tij. Vendimmarrja e asamblesë për përjashtimin e ortakut dhe rëndësia e parashikimeve statutore. Procedura e përjashtimit të ortakut dhe pasojat juridike të kësaj vendimmarrje. Efektet e vendimmarrjes së asamblesë në ndryshim nga largimi i ortakut. Padia për përjashtimin e ortakut. Problemet ligjore lidhur me legjitimimin aktiv dhe atë pasiv.

***Tema 5* : Prishja dhe likuidimi i shoqërive tregtare. Paditë që lidhen me shkaqet e prishjes së shoqërisë (2 orë mësimore).**

Përshkrimi i temës : Në këtë temë në 2 orë mësimore do të trajtohen çështje praktike që kanë të bëjnë me : Shkaqet e prishjes së shoqërive tregtare dhe pasojat ligjore. Likuidimi i zakonshëm dhe i thjeshtuar i shoqërive tregtare. Likuidimi në rrugë gjyqësore dhe jashtëgjyqësore. Pasojat ligjore të mbylljes së procesit të likuidimit.

***Tema 6 :* Natyra e raportit mes shoqërisë dhe administratorit. Paditë që lidhen më shpërblimin financiar të administratorit (2 orë mësimore)**

Përshkrimi i temës : Në këtë temë në 2 orë mësimore do të trajtohen çështje që lidhen me natyrën juridike të të organit të administratorimit sipas LTSHT-së dhe normave statutore. Natyra juridike e padisë për zgjidhjen e pasojave juridike në konfliktet gjyqësore midis administratorit dhe shoqërisë në rastet e largimit të tij nga asambleja e shoqërisë. Natyra e raportit mes shoqërisë dhe administratorit sipas LTSHT-së. A është një marrëdhënie që rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës apo ato të LTSHT-së. Si trajtohet kjo çështje nga praktika gjyqësore e gjykatave shqiptare dhe vendeve të tjera që kanë si model LTSHT-në. Si dhe paditë që lidhen më shpërblimin financiar të administratorit.

Tema 7 : **Falimenti. (5 *orë)***

Përshkrimi i temës : Në 2 orët e para të kësaj teme **(nëntema 1)** do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me qëllimin dhe synimet e procedurës së falimentimit si dhe pritshmëritë prej saj për debitorin dhe kreditorët. Më tej, do të vijohet me parimet që udhëheqin procedurën e falimentimit: Parimi i trajtimit të barabartë dhe i barazisë, Parimi i efektivitetit ekonomik, Parimi i zbatimit të procedurës gjyqësore, Parimi i legjislacionit të zbatueshëm, Parimi i shpejtësisë, Parimi i transparencës dhe i informimit.
Në këtë temë do të ndalohet edhe në aktorët kryesorë të procedurës së falimentimit, duke evidentuar përkufizimet që ligji i falimentimit jep për secilin prej tyre. Në mënyrë të veçantë do të analizohet roli dhe vendi që zë debitori në procedurën e falimentimit, si dhe roli dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit

Në 3 orët e dyta të kësaj teme (nëntema 2), do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me : Hapja e procedurës së falimentimit. Roli i Gjykatës së Falimentimit në mbikëqyrjen dhe realizimin e Procedurës së Riorganizimit: krijimi i planit, miratimi i planit të riorganizimit, mbikëqyrja e zbatimit;Kuptimi i riorganizimit të përshpejtuar dhe dobitë e tij; Shkarkimi nga detyrimet si një procedurë falimentimi e posaçme për individët. Roli i gjykatës në monitorimin e Administratorëve të falimentimit, dhe vendimeve të kreditorëve. Kjo temë do të përqendrohet në shpjegimin e organeve të falimentimit: administratorët e falimentimit, etj.

4.1.2 Metodologjia

Tema 1: Dallimi midis Tregtarit, Shoqërisë së Thjeshtë dhe Shoqërisë Tregtare. Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit. Personaliteti juridik i këtyrë entiteve dhe paditë gjyqësore që lidhen me këto palë (2 orë mësimore).

A. Përmbajtja

Në këtë temë trajtohet çështjet e mëposhtme:

1. Dallimi midis Tregtarit, Shoqërisë së Thjeshtë dhe Shoqërisë Tregtare.
2. Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit.
3. Personaliteti juridik i këtyrë entiteve dhe paditë gjyqësore që lidhen me këto palë.

B. Objektivat mësimorë të temës 1.

Për të arritur objektivat kryesorë të Kursit (shih 3.1. & 3.2., Objektivat dhe Kompetencat), kjo temë synon të arrijë objektivat mësimorë konkretë të listuara më poshtë:

Njohuri : a). Në përfundim të zhvillimit të temës kandidati për ndihmës ligjore :
-ka njohuri të thelluara dhe kuptim të qartë për çështjet që lidhen me personalitetin juridik të tregtarit, shoqërisë së thjeshtë, zyrës së përfaqësimit dhe degës së shoqërisë tregtare.
-klasifikon dhe krahason burimet e së drejtës/autoritetet që zbatohen në praktikën gjyqësore lidhur me çështjet tregtare që lidhen me këtë temë;
-identifikon dhe analizon rastet gjyqësore të natyrës tregtare;
-është i/e aftë për të zbatuar standartet ligjore dhe ato statutore të kompanive në raste praktike.
Aftësi : b) Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati:

-ka aftësi për të analizuar në mënyrë kritike standret gjyqësore të çështjeve me natyrë tregatre;
-është i/e aftë për të arsyetuar dhe arritur në përfundime të qarta/plota/konçize për çështje ligjore dhe statutore;
-është i/e aftë për të arsyetuar dhe zgjidhur çështje me natyrë tregtare në mënyrë bindëse;
-është i/e aftë për të krahasuar, zhvilluar, argumentuar dhe interpretuar çështje me natyrë tregtare sipas standarteve të jursispudencës së vendit dhe asaj europiane.
Qëndrime : c) Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati për dihmës ligjore :
-është i vetëdijshëm për rolin dhe funksionin e tij nga prespektiva ligjore dhe sociale;
-demonstron aftësi për të krahasuar institutet e së drejtës tregtare;
-është i/e aftë për të vlerësuar pasojat për palët;
-është i/e hapur për të ndryshuar qëndrimet e tij nga prespektiva e zhvillimit të praktikës tregtare.
Aftësi joligjore : d). Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati për ndihmës ligjor:
-është në gjendje të përmbledhë në mënyrë të saktë dhe të bëjë pyetje për të kontrolluar kufijtë e kuptimit të çështjes;
-të shprehet qartë dhe saktë, me një gjuhë të përshtatshme dhe të kuptueshme për palët;
-të dëgjojë, reagojë dhe komentojë në mënyrë efektive e konstruktive idetë e shprehura nga kolegët,
-të mbrojë pikëpamjen e tij/saj me vendosmëri dhe, kur është e nevojshme, të heqë dorë prej saj.

C. Plani mësimor dhe metodologjia

KURSI: Gjykime të Specilazuara – Moduli e Drejta Tregtare dhe Kompanive
TEMA 1:
JAVA:
OBJEKTIVAT MËSIMORË (OM): Referohu OM
PEDAGOGËT: **Artan Hajdari**

Plani mësimor- Tema 1: Dallimi midis Tregtarit, Shoqërisë së Thjeshtë dhe Shoqërisë Tregtare. Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit. Personaliteti juridik i këtyrë entiteve dhe paditë gjyqësore që lidhen me këto palë (2 orë mësimore).

ORARI (2 x 50 min)		**AKTIVITETI MËSIMOR**	**METODOLOGJIA**	**SHËNIME**
ORA I	- 20 min - 30	- prezantim/sqarim i çështjeve që lidhen me personalitetin juridik të tregtarit/zyrës së përfaqësimit - dosje gjyqësore/rast praktik	- prezantim në pp - punë në grupe (3-4 grupe)	
	10 Minuta	Pushim		
ORA II	- 20 min - 15 min - 15 min	- diskutim i rastit praktik - pyetje-përgjigje - përmbledhje	- secili grup prezanton 5-6 min - pyetje për secilin grup - përmbledhje- evidentimi i pikave kryesore	

D. Pyetje vetëstudimore, literaturë, jurisprudenca & raste praktike

a) Pyetje vetëstudimore:

1.A ka personalitet juridik Zyra e Përfaqësimit? Po Dega e një shoqërie tregtare?
2. A legjitimohen keto subjekte në kutimin procedurial formal dhe substancial për të qënë palë në një konflikt me natyrë tregtare?

b) Literatura dhe Jurisprudenca

- Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën europiane - Thoms Bachner, Edmund-Philipp Schuster and Martin Ëinner.
- Vendimi i Kolegjit Civil, Nr. 430, datë, 14. 10. 2015 (analizë-shoqëria e thjeshtë).
- Vendim i Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë, Nr. 9933, datë 03. 12. 2018 (shoqëri e sthjeshtë).
- Vendim i Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë, Nr. 1501, date 03. 03. 2020 (shoqëri e thjeshtë).
- Vendim i Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë, Nr. 897, datë 12. 02. 2020 (person fizik).
- Vendim i Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë, Nr. 2207, datë 23. 05. 2017 (shoqëri kolektive).

c). Dosje të praktikës/kazuse

Rasti praktik nr. 1
Nisur nga kriteri i dallimit që lidhet me cilësinë e palës në marrëdhënie, rezulton se, në një kontratë sipërmarrje ndërtimi, baza ligjore që përbën edhe bazën e zgjidhjes së konfliktit është ajo e parashikuar nga Kodi Civil, konkretisht neni 850 e vijues i tij. Por, nga ana tjetër, kemi të përcaktuar një rregull procedural, në Kodin i Procedurës Civile, neni 334 e vijues.

Pyetjet që shtrohen për zgjidhje:

1. Mosmarrëveshja në fjalë do të kualifikohej si një mosmarrëveshje me natyrë tregtare apo civile?
2. Si e tillë do të gjykohej nga seksioni tregtar apo gjykata civile?

Rast praktik 2.
Personi A me cilësinë e tregtarit në kuptim të nenit 1 dhe 2 të LSHT-së, kryen shërbime konsulence ndaj personit B dhe në fund të punës ka lëshuar rregullisht faturën fiskale, e cila rezulton e papaguar nga ky i fundit.
Personi juridik C me cilësinë e shoqërisë tregtare, ka kryer një punë në ndërtim ndaj personit juridik D dhe në fund të punës ka lëshuar rregullisht faturën tatimore, e cila rezulton e pa pagur nga ky i fundit.

Pyetjet që shtrohen për zgjidhje :

1. Në rastin e një konflikti midis personit A dhe B si dhe personit C dhe D, përcaktoni natyrën juridike të tij (konfliktit)?
2. Çfarë ndryshimi ka statusi i personit A dhe personit C sipas LSHT-së?
3. Cili do të ishte kërkimi gjyqësor i ekzekutimit të faturave fiskale?

Rast praktik 3.
Personat A, B, C, D janë në profesion arkitektë dhe së bashku bien dakord që të bashkojnë aftësitë e tyre profesionale (licencat) dhe disa kontribute në të holla, konkretisht nga 10 000 Euro secili, për të krijuar një shoqëri të formës kolektive, me ermin "Studio Architecture".
Tre nga anëtarët themelues, konkretisht A, B dhe C e derdhin kontributin e tyre, në momentin e themelimit, ndërsa anëtari tjetër themelues, personi D, rezulton se nuk e ka derdhur këtë kontribut. Shoqëria fillon aktivitetin e saj duke prodhuar produktet në fushën e projektimeve dhe konstruksionit në ndërtim. Gjatë tërmetit të dhjetorit të vitit 2019, ndër punët e bëra, shoqëria kishte projektuar edhe një pallat banimi në qytetin e Durrësit, i cili u dëmtua rëndë. Në bazë të ekspertizës së kryer nga ana e organeve kompetente, pallati doli i pabanueshëm.
Për këtë ngjarje të rëndë banorët e pallatit fajësuan shoqërinë kolektive "Studio Architecture" dhe iu drejtuan një studio avokatie, e cila i këshilloi që t'i kërkonin dëmin e shkaktuar shoqërisë së ndërtimit "Durrësi Konstruksion shpk" dhe në mënyrë solidare me këtë edhe shoqërisë kolektive "Studio Architecture".
Banorët e pallatit i drejtohen gjykatës me këtë padi me objekt shpërblim dëmi dhe me palë të paditur shoqërinë e ndërtimit "Durrësi Konstruksion shpk" dhe shoqërinë kolektive "Studio Architecture".

Pyetjet që shtrohen për zgjidhje:

1. Në bazë të rregullave që përcakton LSHT-ja për këtë formë shoqërie, cila është përgjegjësia e shoqërisë në raport me të tretët?
2. Po përgjegjësia e ortakëve në raport me shoqërinë dhe me të tretët sipas LSHT-së?
3. A është ndërtuar drejt ndërgjyqësia?

Tema 2: **Natyra juridike e kuotës/aksionit. Paditë gjyqësore që mbrojnë të drejtat që rrjedhin nga kuota/aksioni (3 orë mësimore).**

A. Përmbajtja

Në këtë temë trajtohet çështjet e mëposhtme:
- Natyra juridike e kuotës/aksionit
- Paditë gjyqësore që mbrojnë të drejtat që rrjedhin nga kuota/aksioni.

B. Objektivat mësimorë të temës 2

Për të arritur objektivat kryesorë të Kursit (shih 3.1. & 3.2 Objektivat dhe Kompetencat), kjo temë synon të arrijë objektivat mësimorë konkretë të listuara më poshtë:

Njohuri : a). Në përfundim të zhvillimit të temës kandidati për ndihmës ligjore :
-ka njohuri të thelluara dhe kuptim të qartë për çështjet që lidhen me natyrën juridike yë kuotës/akasionit dhe paditë gjyqësore që lidhen me mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin prej zotërimit të tyre;
-klasifikon dhe krahason burimet e së drejtës/ autoritetet që zbatohen në praktikën gjyqësore lidhur me çështjet tregtare që lidhen me këtë temë;
-identifikon dhe analizon rastet gjyqësore të natyrës tregtare;
-është i aftë për të zbatuar standardet ligjore dhe ato statutore në raste praktike.

Aftësi : b) Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati:
-ka aftësi për të analizuar në mënyrë kritike standardet gjyqësore të çështjeve me natyrë tregtare;
-është i aftë për të arsyetuar dhe arritur në përfundime të qarta/plota/koncizë për çështje ligjore dhe statutore;
-është i aftë për të arsyetuar dhe zgjidhur çështje me natyrë tregtare në mënyrë bindëse;
-është i aftë për të krahasuar, zhvilluar, argumentuar dhe interpretuar çështje me natyrë tregtare sipas standardeve të jurisprudencës së vendit dhe asaj europiane.
Qëndrime : c) Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati për ndihmës ligjore :
-është i vetëdijshëm për rolin dhe funksionin e tij nga prespektiva ligjore dhe sociale;
-demonstron aftësi për të krahasuar institutet e së drejtës tregtare;
-është i aftë për të vlerësuar pasojat për palët;
-është i hapur për të ndryshuar qëndrimet e tij nga prespetiva e zhvillimit të praktiës tregtare .
Aftësi joligjore : d). Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati për ndihmës ligjor:
-është në gjendje të përmbledhë në mënyrë të saktë dhe të bëjë pyetje për të kontrolluar kufijtë e kuptimit të çështjes;
-të shprehet qartë dhe saktë, me një gjuhë të përshtatshme dhe të kuptueshme për palët;
-të dëgjojë, reagojë dhe komentojë në mënyrë efektive e konstruktive idetë e shprehura nga kolegët,
-të mbrojë pikëpamjen e tij/saj me vendosmëri dhe, kur është e nevojshme, të heqë dorë prej saj.

C. Plani mësimor dhe metodologjia

KURSI: Gjykime të Specilazuara – Moduli e Drejta Tregtare dhe Kompanive
TEMA 2:
JAVA:
OBJEKTIVAT MËSIMORË (OM): Referohu OM
PEDAGOGËT: **Artan Hajdari**

Plani mësimor -Tema 2: Natyra juridike e kuotës/aksionit. Paditë gjyqësore që mbrojnë të drejtat që rrjedhin nga kuota/aksioni.

ORARI (2 x 50 min)		**AKTIVITETI MËSIMOR**	**METODOLOGJIA**	**SHËNIME**
ORA I	- 20 min - 30	- prezantim/sqarim i çështjeve që lidhen natyrën juridike e kuotës/ Paditë gjyqësore që mbrojnë të drejtat që rrjedhin nga kuota - dosje gjyqësore/rast praktik	- prezantim në pp - punë në grupe (3-4 grupe)	
	10 Minuta	Pushim		
ORA II	- 20 min - 15 min - 15 min	- diskutim i rastit praktik - pyetje-përgjigje - përmbledhje	- secili grup prezanton 5-6 min - pyetje për secilin grup - përmbledhje- evidentimi i pikave kryesore	

	10 Minuta	Pushim		
ORA III	- 20 min - 15 min - 15 min	- diskutim i rastit praktik - pyetje-përgjigjje - përmbledhje	- secili grup prezanton 5-6 min - pyetje për secilin grup - përmbledhje- evidentimi i pikave kryesore	

D. Pyetje vetëstudimore, literaturë, jurisprudenca & raste praktike

a) Pyetje vetëstudimore:

1. Çfarë është kuota/aksioni në kategorinë juridike të së drejtës private??
2. Cilat kritere të LSHT-së do të përcaktonin të drejtat politike të kuotës/aksionit dhe cilat janë?
3. Cilat janë mënyrat e njohura me ligj për kalimin e kuotës/aksionit?
4. A pjesëtohet kuota/aksioni ?

b). Literatura dhe Jurisprudenca

- Galgano, Francesco. "E drejta private", botim i shtëpisë botuese Luarasi.
- Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën europiane - Thoms Bachner, Edmund-Philipp Schuster and Martin Ëinner
- Vendimi nr. 777, datë 7.2.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 103, datë 29.1.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Vendimi nr. 10334, datë 19.12.2016 i Gjykatës Tiranë.
- Vendimi nr. 9423, datë 21.11.2016 i Gjykatës Tiranë.
- Vendimi nr.1074, datë 12.4.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Vendimi nr. 4251, datë 23.5.2011 i Gjykatës Tiranë.
- Vendimi nr.816, datë 12.4.2016 i Gjykatës së Apelit Durrës.
- Vendimi nr.5620, datë 11.10.2017 i Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Vendimi nr. 568, datë 30.1.2012 i Gjykatës Tiranë.
- Vendimi nr. 1036, datë 8.2.2012 i Gjykatës Tiranë.

c). Dosje të praktikës/kazuse

Rast praktik 1:

Personi A dhe personi B janë burrë dhe grua. Personi A (bashkëshorti) gjatë martesës ka themeluar dhe regjistruar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar X sh.p.k., në të cilën ai është njëkohësisht dhe administrator. Ortaku A nëpërmjet një kontrate dhurimi, ka kaluar 50% të kuotës te personi B, pra bashkëshortja e tij. Menjëherë pas firmosjes së kontratës midis bashkëshortëve lind një konflikt dhe personi A, që është njëkohësisht edhe administrator i shoqërisë, pezullon çdo veprim për regjistrimin në QKB të kuotës së kalimit të kuotës nëpërmjet dhurimit.

Pyetjet që shtrohen për zgjidhje :

1. Si do të bëhet regjistrimi i kalimit të kuotës?
2. A mund personi B (bashkëshortja) të kërkojë regjistrimin e kontratës apo kjo sipas pikës 2 të nenit 74 është vetëm një detyrim i shoqërisë?

3. Në cilin moment fillojnë të drejtat dhe detyrimet e B-së, të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga kalimi i kuotës? A fillojnë këto të drejta dhe detyrime nga momenti i pranimit të dhurimit? Cili është momenti në të cilin B-ja fiton cilësinë e ortakut dhe kur i lind atij përgjegjësia solidare?
4. Në Qendrën Kombëtare të Biznesit, regjistrohet vetëm kontrata apo dhe vendimi i ortakut të vetëm që ka vendosur kalimin e kuotës dhe bashkë me të edhe ndryshimet përkatëse në statut?

Rast praktik 2.
Personi A gjatë martesës me personin B, ka themeluar një shoqëri të formës aksionere.
Rezulton se pronësia midis tyre i nënshtrohet regjimit të bashkësisë ligjore.
Pas disa vitesh aktivitet ai ia shet aksionet që zotëron në masën 100 %, personit C kundrejt një çmimi që nuk e kënaq bashkëshorten e tij B.
Rezulton se shoqëria pas ndërrimit të pronësisë mbi aksionet ka hyrë në marrëdhënie të qenësishme me të tretët. Kjo e fundit pasi bie në dijeni të shitjes dhe çmimit dhe pas një afati 4-vjeçar nga shitja i drejtohet gjykatës me padi me objekt: kthimin e të drejtave mbi aksionet në emër të shitësit për shkak se shitja është bërë pa marrë pëlqimin e saj.

Pyetjet që shtrohen për zgjidhje :
1. Çfarë natyre juridike ka konflikti në fjalë civile apo tregtare?
2. A është e vlefshme kontrata e shitjes së aksioneve të A-së, pa marrë pëlqimin e në formën e kërkuar nga ligji të bashkëshortes B?
3. A ka të drejtë bashkëshortja B të ngrejë padinë për pavlefshmërinë e veprimit juridik në çdo kohë?
4. Jepni dispozitivin e vendimit.

Tema 3 : Natyra juridike e funksionit të brendshëm të shoqërisë. Paditë gjyqësore që lidhen më kundërshtimin e akteve të organeve të shoqërisë tregtare (3 orë mësimore).

A. Përmbajtja

Në këtë temë trajtohet çështjet e mëposhtme:
-Natyra juridike e funksionit të brendshëm të shoqërisë.
-Paditë gjyqësore që lidhen më kundërshtimin e akteve të organeve të shoqërisë tregtare

B. Objektivat mësimorë të temës 3.

Për të arritur objektivat kryesorë të Kursit (shih 3.1. & 3.2 Objektivat dhe Kompetencat), kjo temë synon të arrijë objektivat mësimorë konkretë të listuara më poshtë:

Njohuri : a). Në përfundim të zhvillimit të temës kandidati për ndihmës ligjore :
-ka njohuri të thelluara dhe kuptim të qartë për çështjet që lidhen me natyrën juridike të akteve që nxjerin organet e shoqërisë gjatë veprimtarisë së tyre dhe paditë që lidhen më kundërshtimin e tyre dhe zgjidhjen e pasojave juridike përkatëse;
-klasifikon dhe krahason burimet e së drejtës/ autoritetet që zbatohen në praktikën gjyqësore lidhur me çështjet tregtare që lidhen me këtë temë;
-identifikon dhe analizon rastet gjyqësore të natyrës tregtare;

-është i aftë për të zbatuar standardet ligjore dhe ato statutore në raste praktike.
Aftësi : b) Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati:
-ka aftësi për të analizuar në mënyrë kritike standret gjyqësore të çështjeve me natyrë tregatre
-është i aftë për të arsyetuar dhe arritur në përfundime të qarta/plota/konçize për çështje ligjore dhe statutore;
-është i aftë për të arsyetuar dhe zgjidhur çështje me natyrë tregtare në mënyrë bindëse;
-është i aftë për të krahasuar, zhvilluar, argumentuar dhe interpretuar çështje me natyrë tregtare sipas standarteve të jursispudencës së vendit dhe asaj europiane.
Qëndrime : c) Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati për dihmës ligjore :
-është i vetëdijshëm për rolin dhe funksionin e tij nga prespektiva ligjore dhe sociale;
-demonstron aftësi për të krahasuar institutet e së drejtës tregtare;
-është i aftë për të vlerësuar pasojat për palët;
-është i hapur për të ndryshuar qëndrimet e tij nga prespetiva e zhvillimit të praktiës tregtare .
Aftësi joligjore : d). Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati për ndihmës ligjor:
-është në gjendje të përmbledhë në mënyrë të saktë dhe të bëjë pyetje për të kontrolluar kufijtë e kuptimit të çështjes;
-të shprehet qartë dhe saktë, me një gjuhë të përshtatshme dhe të kuptueshme për palët;
-të dëgjojë, reagojë dhe komentojë në mënyrë efektive e konstruktive idetë e shprehura nga kolegët,
-të mbrojë pikëpamjen e tij/saj me vendosmëri dhe, kur është e nevojshme, të heqë dorë prej saj.

C. Plani mësimor dhe metodologjia

KURSI: Gjykime të Specilazuara – Moduli e Drejta Tregtare dhe Kompanive **TEMA 3:** **JAVA:** **OBJEKTIVAT MËSIMORË (OM):** Referohu OM **PEDAGOGËT:** **Alma Hicka/Artan Hajdari**				
Plani mësimor- Tema 3: Natyra juridike e funksionit të brendshëm të shoqërisë. Paditë gjyqësore që lidhen më kundërshtimin e akteve të organeve të shoqërisë tregtare (3 orë mësimore).				
ORARI (2 x 50 min)		**AKTIVITETI MËSIMOR**	**METODOLOGJIA**	**SHËNIME**
ORA I	- 20 min - 30	- prezantim/sqarim i çështjeve që lidhen me natyrën juridike të funksionit të brendshëm të shoqërisë/Paditë gjyqësore që lidhen më kundërshtimin e akteve të organeve të shoqërisë tregtare -dosje gjyqësore/rast praktik	- prezantim në pp - punë në grupe (3-4 grupe)	
	10 Minuta	Pushim		

ORA II	- 20 min - 15 min - 15 min	- diskutim i rastit praktik - pyetje-përgjigjje - përmbledhje	- secili grup prezanton 5-6 min - pyetje për secilin grup - përmbledhje- evidentimi i pikave kryesore	
	10 Minuta	Pushim		
ORA III	- 20 min - 15 min - 15 min	- diskutim i rastit praktik - pyetje-përgjigjje - përmbledhje	- secili grup prezanton 5-6 min - pyetje për secilin grup - përmbledhje- evidentimi i pikave kryesore	

D. Pyetje vetëstudimore, literaturë, jurisprudenca & raste praktike

a) Pyetje vetëstudimore:

1. Cilat janë karakteristikat e akteve që nxjerrin organet e shoqërisë në funksionin e tyre të brendshëm?
2. Cili do të ishte rrethi i personave të interesuar që mund të ngrenë padinë për të kundërshtuar këto katë në gjykatë?
3. Duke vënë përballë konceptin e pavlefshmërisë së akteve që prodhojnë organet e shoqërisë dhe atë të veprimit juridik sipas trajtimit tradicional që i bëjmë në të drejtën civile, cilat do të mund të ishin disa nga konkluzionet me karakter praktik për natyrën e pavlefshmërisë së tyre?

b). Literaturë dhe Jurispudencë

- Galgano, Francesco. "E drejta private", botim i shtëpisë botuese Luarasi.
- Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën europiane - Thoms Bachner, Edmund-Philipp Schuster and Martin Ëinner.
- Vendimi nr.1112, datë 27.2.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr.942, datë 12.2.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr.4225 datë 19.5.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 3417, datë 21.3.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr.10182, datë 13.12.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr.4280, datë 23.5.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 4251, datë 23.5.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 3679, datë 6.5.2011 i Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi e Gjykatës së Lartë nr. 310, datë 9.6.2011.
- Vendimi nr. 3427, datë 10.4.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 4413, datë 7.4.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 107 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

c). Dosje të praktikës/kazuse

Rasti praktik nr. 1

Nisur nga kriteri i dallimit që lidhet me cilësinë e palës në marrëdhënie, në një kontratë sipërmarrje ndërtimi, baza ligjore që përbën edhe bazën e zgjidhjes së konfliktit është ajo e parashikuar nga Kodi Civil, konkretisht neni 850 e vijues i tij.
Po kështu nga ana tjetër kemi edhe përcaktimin e Kodit të Procedurës Civile, neni 334 e vijues i tij, sipas të cilit, mosmarrëveshja do të kualifikohej si tregtare dhe si e tillë do të gjykohej nga seksioni tregtar.

Pyetjet që shtrohen për zgjidhje:

1. Që një marrëdhënie të konsiderohet tregtare mjafton vetëm përcaktimi i nenit 334 të Kodit të Procedurës Civile?
2. Përcaktimi i bazës ligjore në kontratën e mësipërme çfarë natyre i jep marrëdhënies së sipërmarrjes?

Rast praktik 2.
Shoqëria "Projeksion Energji" në cilësinë e paditësit ka kërkuar përpara gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përjashtimin e ortakut L.H, njëkohësisht ish-administrator i shoqërisë, palë e paditur në proces, për rezultat të veprimeve të paligjshme të këtij të fundit, që kanë dëmtuar rëndë interesat e shoqërisë. Në këtë proces pala e paditur ka paraqitur një kundërpadi, duke kërkuar pavlefshmërinë e vendimeve të marra nga asambleja, për shkak se ka qenë i deformuar vullneti i njërit prej ortakëve. Në lidhje me padinë, janë parashtruar argumentet dhe provat sipas të cilave është vërtetuar me vendim përfundimtar se kanë qenë veprime të paligjshme të ortakut që kanë dëmtuar interesat e shoqërisë dhe që legjitimojnë përjashtimin e tij.

Pyetja që shtrohen për zgjidhje :

1. Nisur nga natyra juridike e pasojave të akteve të organeve të personit juridik, jepni mendimin tuaj në lidhje me rastin e mësipërm

***Tema* 4 *:* Paditë që lidhen me largimin dhe përjashtimin e ortakut. Paditë e ortakut/shoqërisë që lidhen më likujdimin e kuotës dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e largimit/përjashtimit (3 orë mësimore).**

A. Përmbajtja Në këtë temë trajtohet çështjet e mëposhtme:
-Largimi ortakut.
-Padia për përjashtimi i ortakut.
-Paditë e ortakut/shoqërisë që lidhen më likujdimin e kuotës dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e largimit/përjashtimit.

B. Objektivat mësimorë të temës 4.

Për të arritur objektivat kryesorë të Kursit (shih 3.1. & 3.2 Objektivat dhe Kompetencat), kjo temë synon të arrijë objektivat mësimorë konkretë të listuara më poshtë:

Njohuri : a). Në përfundim të zhvillimit të temës kandidati për ndihmës ligjore :
-ka njohuri të thelluara dhe kuptim të qartë për çështjet që lidhen me institutin e largimit dhe përjashtimit të ortakut në një shoqëri tregtare;
-klasifikon dhe krahason burimet e së drejtës/ autoritetet që zbatohen në praktikën gjyqësore lidhur me çështjet tregtare që lidhen me këto insititute;

-identifikon dhe analizon rastet gjyqësore të natyrës tregtare;
-është i aftë për të zbatuar standardet ligjore dhe ato statutore në raste praktike.
Aftësi : b) Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati:
-ka aftësi për të analizuar në mënyrë kritike standret gjyqësore të çështjeve me natyrë tregtare
-është i aftë për të arsyetuar dhe arritur në përfundime të qarta/plota/konçize për çështje ligjore dhe statutore;
-është i aftë për të arsyetuar dhe zgjidhur çështje me natyrë tregtare në mënyrë bindëse;
-është i aftë për të krahasuar, zhvilluar, argumentuar dhe interpretuar çështje me natyrë tregtare sipas standarteve të jursispudencës së vendit dhe asaj europiane.
Qëndrime : c) Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati për dihmës ligjore :
-është i vetëdijshëm për rolin dhe funksionin e tij nga prespektiva ligjore dhe sociale;
-demonstron aftësi për të krahasuar institutet e së drejtës tregtare;
-është i aftë për të vlerësuar pasojat për palët;
-është i hapur për të ndryshuar qëndrimet e tij nga prespetiva e zhvillimit të praktiës tregtare .
Aftësi joligjore : d). Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati për ndihmës ligjor:
-është në gjendje të përmbledhë në mënyrë të saktë dhe të bëjë pyetje për të kontrolluar kufijtë e kuptimit të çështjes;
-të shprehet qartë dhe saktë, me një gjuhë të përshtatshme dhe të kuptueshme për palët;
-të dëgjojë, reagojë dhe komentojë në mënyrë efektive e konstruktive idetë e shprehura nga kolegët,
-të mbrojë pikëpamjen e tij/saj me vendosmëri dhe, kur është e nevojshme, të heqë dorë prej saj.

C. Plani mësimor dhe metodologjia

KURSI: Gjykime të Specilazuara – Moduli e Drejta Tregtare dhe Kompanive
TEMA 4:
JAVA:
OBJEKTIVAT MËSIMORË (OM): Referohu OM
PEDAGOGËT: **Alma Kodraliu/Artan Hajdari**

Plani mësimor- Tema 4: Paditë që lidhen me largimin dhe përjashtimin e ortakut. Paditë e ortakut/shoqërisë që lidhen më likujdimin e kuotës dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e largimit/përjashtimit (3 orë mësimore).

ORARI (2 x 50 min)		AKTIVITETI MËSIMOR	METODOLOGJIA	SHËNIME
ORA I	- 20 min - 30	- prezantim/sqarim i çështjeve që lidhen me, insitutin e largimit dhe përjashtimit të ortakut/Paditë gjyqësore që lidhen me zgjidhjen e pasojave që vijnë nga vendimarja e organeve të shoqërisë. -dosje gjyqësore/rast praktik	- prezantim në pp - punë në grupe (3-4 grupe)	

	10 Minuta	Pushim		
ORA II	- 20 min - 15 min - 15 min	- diskutim i rastit praktik - pyetje-përgjigjje - përmbledhje	- secili grup prezanton 5-6 min - pyetje për secilin grup - përmbledhje- evidentimi i pikave kryesore	
	10 Minuta	Pushim		
ORA III	- 20 min - 15 min - 15 min	- diskutim i rastit praktik - pyetje-përgjigjje - përmbledhje	- secili grup prezanton 5-6 min - pyetje për secilin grup - përmbledhje- evidentimi i pikave kryesore	

D. Pyetje vetëstudimore, literaturë, jurisprudenca & raste praktike

a) Pyetje vetëstudimore:

1. Si ndërthuren normat e ligjit "Për shoqëritë tregtare" me ato të së drejtës procedurale civile në rastin kur ortaku që ka shfaqur vullnetin për largim nuk ka shteruar procedurën e brendshme të shoqërisë për njoftimin e largimit dhe likuidimin e kuotës? Disponimet e gjykatës.
2. Cilat janë veprimet juridike që do të duhet të kryejë administratori në rastin kur asambleja e ortakëve pranon kërkesën për largim të ortakut dhe likuidim të kuotës, për pasqyrimin e ndryshimeve në QKB pas largimit të ortakut në zbatim të ligjit "Për shoqëritë tregtare" dhe dispozitat e ligjit nr. 131/2015, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" për pasqyrimin e ndryshimeve në QKB pas largimit të ortakut?
3. Cilat kritere ligjore do të përdorin gjykatat për të arritur një vlerësim ekonomik real të vlerës së kuotës?
4. A legjitimohet asambleja e përgjithëshme në ngritjen e padisë për përjashtimit e ortakut?
5. Si do të formohet ndërgjyqësia në padinë e përjashtimit të ortakut?
6. Cila janë pasojat e përjashtimit në kuptimin ligjor dhe atë ekonomik?

b). Literaturë dhe jurisprudenca.

- Galgano, Francesco. "E drejta private", botim i shtëpisë botuese Luarasi.
- Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën europiane - Thoms Bachner, Edmund-Philipp Schuster and Martin Ëinner.
- Vendimi nr.10182, datë 13.12.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 479, datë 23.10.2012 i Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Vendimi nr. 7601, datë 12.10.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 694, datë 23.3.2017 i Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Vendimi nr. 165, datë 18.5.2016 i Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 488, datë 25.11.2015 i Gjykatës së Lartë.
- Vendimi i datës 1.3.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditës: Asambleja e ortakëve e Shoqërisë "Infigo is" sh.p.k. dhe i paditur Shoqëria Infigo is d.o.o, shoqëri kroate, me objekt përjashtimi i ortakut INFIGO IS d.o.o, nga shoqëria "INFIGO IS" sh.p.k.

c). Dosje gjoqësore/Raste praktike.

Rast Praktik 1

Shoqëria tregtare, "Shpresa sh.p.k" ka dy ortakë me 50% të kapitalit secili. Ortaku B.M., zotërues i 50% të kapitalit, ka njoftuar administratorin e shoqërisë për qëllimin e tij për t'u larguar nga shoqëria për shkaqe të arsyeshme dhe ka kërkuar likuidimin e kuotës. Njoftimi i është nisur shoqërisë duke iu adresuar administratorit të saj, njëkohësisht ortak me 50% të kapitalit dhe prej shoqërisë nuk ka pasur asnjë përgjigje apo reagim. Në këto kushte ortaku B.M i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar likuidimin e kuotës. Gjykata kompetente që në rastin tonë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit, me argumentin se, ligji tregtar detyron ortakun të kërkojë largimin duke i paraqitur kërkesën me shkrim asamblesë të shoqërisë dhe njëkohësisht duke i parashtruar shkaqet, dhe është kjo e fundit kompetente për të vendosur në lidhje me të.

Pyetja shtrohet për zgjidhje :

1. Nisur nga përcaktimi i natyrës së funksionit të brendshëm të organeve të shoqërisë, a është i drejtë vendimi i gjykatës së rrethit Fier?

Rasti praktik nr. 2

Ortaku i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar i drejtohet gjykatës me padi duke kërkuar largimin e tij nga shoqëria dhe detyrimin e shoqërisë të likuidojë kuotën e tij. Në deklaratën e mbrojtjes shoqëria prapëson duke argumentuar se nuk është njoftuar asnjëherë më parë për një kërkesë të tillë nga ortaku dhe në këto kushte kërkon rrëzimin e kërkesës së paraqitur.

Pyetje që shtrohet për zgjidhje:

1. A ka të drejtë ortaku të kërkojë drejtpërdrejt në gjykatë largimin e tij nga shoqëria? Cili do të ishte vendimi me të cilin do të disponojë gjykata në një situatë të tillë, të vërtetuar sipas prapësimit?

Rasti praktik nr. 3

Ortaku i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ka kërkuar largimin e tij nga shoqëria dhe likuidimin e kuotës pasi ka respektuar procedurën e brendshme, duke ia njoftuar kërkesën me shkrim shoqërisë. Asambleja e shoqërisë ka disponuar për pranimin e kërkesës për largimin e ortakut, por ka refuzuar kërkesën për likuidimin e kuotës. Ortaku bën padi në gjykatë duke kërkuar detyrimin e shoqërisë të paguajë vlerën e likuidimit të kuotës dhe shpërblimin e dëmit. Gjykata disponon për rrëzimin e kërkesës duke arsyetuar se shoqëria rezulton me humbje për shkak se është në fazë investimi.

Pyetje që shtrohen për zgjidhje:

1. A është i mjaftueshëm vërtetimi i një situate të tillë për të konkluduar rrëzimin e kërkesës për likuidimin e kuotës?
2. Çfarë kriteresh juridike dhe ekonomike duhet të mbahen parasysh nga gjykata për të arritur gjyqësisht për vlerësimin ekonomik të kuotës?

3. Nëse disponohet për vlerësimin e kuotës në një shumë të caktuar, a mundet gjykata të disponojë duke e ndarë në këste shumën, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet e nenit 77 të LSHT-së?

Rast praktik nr. 4

Në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ortaku "A" zotëron 70% të kuotave, ndërkohë që ortaku "B" zotëron 30%. Ortaku "B" ka kërkuar për disa vite rresht shpërndarjen e dividentit, por nuk ka pasur një vendimmarrje për këtë qëllim.

Pyetje që shtrohen për zgjidhje:

1. A mundet ortaku "B" që zotëron 30% të kuotave të shoqërisë, të kërkojë përjashtimin e ortakut "A", duke parashtruar si shkak mos shpërndarjen e dividentit?
2. Çfarë duhet të hetojë gjykata në këto raste?
3. Çfarë çështjesh procedurale dhe materiale duhen pasur parasysh?

Rasti praktik nr. 5

Në një shoqëri me dy ortakë me nga 50% secili, njëri prej tyre, njëkohësisht dhe administrator, kishte marrë shuma të ndryshme hua dhe i kishte shlyer përmes fitimeve të shoqërisë, kishte përfituar shuma nga kontratat e shoqërisë me të tretë, duke mos i derdhur në llogaritë e shoqërisë, e po kështu, kishte krijuar një shoqëri tjetër me 100% të kuotave, me të njëjtin objekt veprimtarie me atë të shoqërisë, duke i shkaktuar dhe ulje të veprimtarisë tregtare.

Pyetje që shtrohen për zgjidhje:

1. Cilat parime janë shkelur nga ana e ortakut? Për çfarë shkaqesh mund të kërkohet përjashtimi i ortakut?

Rast praktik nr. 6

Në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ortaku "A" zotëron 70% të kuotave, ndërkohë që ortaku "B" zotëron 30%. Ortaku "B" ka kërkuar për disa vite rresht shpërndarjen e dividentit, por nuk ka pasur një vendimmarrje për këtë qëllim.

Pyetje që shtrohen për zgjidhje:

1. A mundet ortaku "B" që zotëron 30% të kuotave të shoqërisë, të kërkojë përjashtimin e ortakut "A", duke parashtruar si shkak mos shpërndarjen e dividentit?
2. Çfarë duhet të hetojë gjykata në këto raste?
3. Çfarë çështjesh procedurale dhe materiale duhen pasur parasysh?

***Tema 5* : Prishja dhe likujdimi shoqërive tregtare. Paditë që lidhen me shkaqet e prishjes së shoqërisë (2 orë mësimore).**

A. Përmbajtja

Në këtë temë trajtohet çështjet e mëposhtme:
-shkaqet e prishjes se shoqërive tregtare;
-likujdimi si zgjidhje e pasojës së vertetimit të shkakut të prishjes.

-llojet e likujdimit të shoqërië;
-paditë që lidhen me shkaqet e prishjes së shoqërise. Likujdimi në rrugë gjyqësore.

B. Objektivat mësimorë të temës 5.

Për të arritur objektivat kryesorë të Kursit (shih 3.1. & 3.2 Objektivat dhe Kompetencat), kjo temë synon të arrijë objektivat mësimorë konkretë të listuara më poshtë:

Njohuri : a). Në përfundim të zhvillimit të temës kandidati për ndihmës ligjore :
-ka njohuri të thelluara dhe kuptim të qartë për çështjet që lidhen me natyrën juridike të shkaqeve prishjes së shoqërisë dhe zgjidhjen e pasojave përkatëse nëpërmjet llojeve/formave të likujdimit;
-klasifikon dhe krahason burimet e së drejtës/ autoritetet që zbatohen në praktikën gjyqësore lidhur me çështjet tregtare që lidhen me këto insititute;
-identifikon dhe analizon rastet gjyqësore të natyrës tregtare;
-është i aftë për të zbatuar standardet ligjore dhe ato statutore në raste praktike.
Aftësi : b) Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati:
-ka aftësi për të analizuar në mënyrë kritike standret gjyqësore të çështjeve me natyrë tregtare
-është i aftë për të arsyetuar dhe arritur në përfundime të qarta/plota/konçize për çështje ligjore dhe statutore;
-është i aftë për të arsyetuar dhe zgjidhur çështje me natyrë tregtare në mënyrë bindëse;
-është i aftë për të krahasuar, zhvilluar, argumentuar dhe interpretuar çështje me natyrë tregtare sipas standarteve të jursispudencës së vendit dhe asaj europiane.
Qëndrime : c) Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati për dihmës ligjore :
-është i vetëdijshëm për rolin dhe funksionin e tij nga prespektiva ligjore dhe sociale;
-demonstron aftësi për të krahasuar institutet e së drejtës tregtare;
-është i aftë për të vlerësuar pasojat për palët;
-është i hapur për të ndryshuar qëndrimet e tij nga prespetiva e zhvillimit të praktiës tregtare .
Aftësi joligjore : d). Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati për ndihmës ligjor:
-është në gjendje të përmbledhë në mënyrë të saktë dhe të bëjë pyetje për të kontrolluar kufijtë e kuptimit të çështjes;
-të shprehet qartë dhe saktë, me një gjuhë të përshtatshme dhe të kuptueshme për palët;
-të dëgjojë, reagojë dhe komentojë në mënyrë efektive e konstruktive idetë e shprehura nga kolegët,
-të mbrojë pikëpamjen e tij/saj me vendosmëri dhe, kur është e nevojshme, të heqë dorë prej saj.

C. Plani mësimor dhe metodologjia

KURSI: Gjykime të Specilazuara – Moduli e Drejta Tregtare dhe Kompanive **TEMA 5:** **JAVA:** **OBJEKTIVAT MËSIMORË (OM):** Referohu OM **PEDAGOGËT:** **Artan Hajdari**			
Plani mësimor- Tema 5: Prishja dhe likujdimi shoqërive tregtare. Paditë që lidhen me shkaqet e prishjes së shoqërisë (2 orë mësimore).			
ORARI (2 x 50 min)	**AKTIVITETI MËSIMOR**	**METODOLOGJIA**	**SHËNIME**

ORA I	- 20 min - 30	- prezantim/sqarim i çështjeve që lidhen me, institutin e likujdimit të shoqërive tregtare/llojet e likujdimit/Paditë gjyqësore që lidhen me zgjidhjen e pasojave që vijnë nga prishja e shoqërisë -dosje gjyqësore/rast praktik	- prezantim në pp - punë në grupe (3-4 grupe)	
	10 Minuta	Pushim		
ORA II	- 20 min - 15 min - 15 min	- diskutim i rastit praktik - pyetje-përgjigjje - përmbledhje	- secili grup prezanton 5-6 min - pyetje për secilin grup - përmbledhje- evidentimi i pikave kryesore	

D. Pyetje vetëstudimore, literaturë, jurisprudenca & raste praktike

a). Pyetje vetëstudimore

1. A është e mundur prishja/ndryshimi i vendimit të prishjes së shoqërisë, pas fillimit të procesit të likuidimit, kur:
2. Ky vendim është marrë nga asambleja e përgjithshme;
3. Ky vendim është marrë nga gjykata.

b). Literaturë dhe jurisprudenca.

- Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën europiane - Thoms Bachner, Edmund-Philipp Schuster and Martin Ëinner.
  Dine Janet, Michael Blecher. *Komentar i ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, Tiranë: Botim i Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, 2016.
  -Vendimi nr. 487, datë 4.3.2003 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
  -Vendimi nr. 358, datë 29.3.2001 i Gjykatës së Apelit Tiranë.
  -Vendimi nr. 1411, datë 26.6.2006 i Gjykatës së Rrethit Korçë.
  -Vendimi Unifikues nr. 13, datë 9.3.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
  -Vendimi nr. 2002, datë 8.5.2006 i Gjykatës së shkallës së parë Tiranë.
  -Vendimi nr.501, datë 9.10.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
  -Vendimi nr. 476, datë 18.9.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
  -Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 580, datë 16.5.2017.
  -GJRRGJTR - vendimi nr.1976, datë 2.3.2018. gykata e Apelit Tiranë: vendimi nr. 3216, datë 25.9.2014; vendimi nr.170, datë 1.2.2011; vendimi nr.30-2014-2228, datë 8.4.2014; vendimi nr.30-2017-2560, datë 2.5.2017.

c). Dosje gjyqësore & Raste praktike.

Rast praktik.
Shoqëria F, e përbërë nga ortakët: A, B dhe C, të tre profesionistë të një fushe, është krijuar me qëllim që të tre ortakët të garojnë në tendera publikë dhe privatë me qëllim ofrimin e konsulencës në fushën e tyre të ekspertizës, për ato raste kur kriteret e tenderit kërkojnë grup ekspertësh për hartimin e konsulencës. Ortaku C vdes dhe kuotat e tij kalojnë në emër të trashëgimtarëve të tij ligjor. Duke qenë se këta të fundit nuk mund të ofronin shërbime konsulence, pasi nuk ishin ekspertë të fushës, ortakët A dhe B ofrojnë të blejnë kuotat e C-së, por palët nuk bien dakord për çmimin dhe për pasojë asambleja e shoqërisë vendos prishjen dhe kalimin e subjektit në likuidim. Vendimi regjistrohet në regjistrin tregtar. Pas çeljes së procesit të likuidimit palët arrijnë marrëveshje për çmimin e kuotës së C dhe në vijim, ortakët marrin vendim prishjen e vendimeve të prishjes së shoqërisë dhe çeljes së likuidimit dhe i kërkojnë QKB-së regjistrimin e kësaj vendimmarrjeje.

Pyetjet që shtrohen për zgjidhje :

- A duhet QKB-ja ta pranojë një kërkesë të tillë? A ka një afat kohor deri kur vendimi për rikthimin e shoqërisë në status aktiv mund të pranohet?

Tema 6 : **Natyra e raportit mes shoqërisë dhe administratorit. Paditë që lidhen më shpërbimin financiar të administratorit (2 orë mësimore)**

A. **Përmbajtja**.
   -Natyra e mardhënies midis shoqërisë dhe administratorit;
   -Padia për zgjidhjen e pasojave financiare që vijnë nga largimi/shkakrimi i administratorit.

B. **Objektivat mësimorë të temës 6.**

Për të arritur objektivat kryesorë të Kursit (shih 3.1. & 3.2 Objektivat dhe Kompetencat), kjo temë synon të arrijë objektivat mësimorë konkretë të listuara më poshtë:

Njohuri : a). Në përfundim të zhvillimit të temës kandidati për ndihmës ligjore :
-ka njohuri të thelluara dhe kuptim të qartë për çështjet që lidhen me natyrën juridike mardhënies midis shoqërisë dhe administratorit dhe padisë për zgjidhjen e pasojave financiare që vijnë nga largimi/shkakrimi i administratorit.
-klasifikon dhe krahason burimet e së drejtës/ autoritetet që zbatohen në praktikën gjyqësore lidhur me çështjet tregtare që lidhen me këto insititute;
-identifikon dhe analizon rastet gjyqësore të natyrës tregtare;
-është i aftë për të zbatuar standardet ligjore dhe ato statutore në raste praktike.
Aftësi : b) Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati:
-ka aftësi për të analizuar në mënyrë kritike standret gjyqësore të çështjeve me natyrë tregtare
-është i aftë për të arsyetuar dhe arritur në përfundime të qarta/plota/konçize për çështje ligjore dhe statutore;
-është i aftë për të arsyetuar dhe zgjidhur çështje me natyrë tregtare në mënyrë bindëse;

-është i aftë për të krahasuar, zhvilluar, argumentuar dhe interpretuar çështje me natyrë tregtare sipas standarteve të jursispudencës së vendit dhe asaj europiane.
Qëndrime : c) Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati për dihmës ligjore :
-është i vetëdijshëm për rolin dhe funksionin e tij nga prespektiva ligjore dhe sociale;
-demonstron aftësi për të krahasuar institutet e së drejtës tregtare;
-është i aftë për të vlerësuar pasojat për palët;
-është i hapur për të ndryshuar qëndrimet e tij nga prespetiva e zhvillimit të praktiës tregtare .
Aftësi joligjore : d). Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati për ndihmës ligjor:
-është në gjendje të përmbledhë në mënyrë të saktë dhe të bëjë pyetje për të kontrolluar kufijtë e kuptimit të çështjes;
-të shprehet qartë dhe saktë, me një gjuhë të përshtatshme dhe të kuptueshme për palët;
-të dëgjojë, reagojë dhe komentojë në mënyrë efektive e konstruktive idetë e shprehura nga kolegët,
-të mbrojë pikëpamjen e tij/saj me vendosmëri dhe, kur është e nevojshme, të heqë dorë prej saj.

C. Plani mësimor dhe metodologjia

KURSI: Gjykime të Specilazuara – Moduli e Drejta Tregtare dhe Kompanive
TEMA 6:
JAVA:
OBJEKTIVAT MËSIMORË (OM): Referohu OM
PEDAGOGËT: **Artan Hajdari**

Plani mësimor- Tema 6: Natyra e raportit mes shoqërisë dhe administratorit. Paditë që lidhen më shpërbimin financiar të administratorit (2 orë mësimore).
.

ORARI (2 x 50 min)		**AKTIVITETI MËSIMOR**	**METODOLOGJIA**	**SHËNIME**
ORA I	- 20 min - 30	- prezantim/sqarim i çështjeve që lidhen me natyrën e raportit mes shoqërisë dhe administratorit/ Paditë gjyqësore që lidhen me zgjidhjen e pasojave financiare që vijnë nga prishja e këtij raporti -dosje gjyqësore/rast praktik	- prezantim në pp - punë në grupe (3-4 grupe)	
	10 Minuta	Pushim		
ORA II	- 20 min - 15 min - 15 min	- diskutim i rastit praktik - pyetje-përgjigjje - përmbledhje	- secili grup prezanton 5-6 min - pyetje për secilin grup - përmbledhje- evidentimi i pikave kryesore	

D. Pyetje vetëstudimore, literaturë, jurisprudenca & raste praktike

a). Pyetje vetëstudimore

1. A do të përgjigjej shoqëria përballë të tretëve për dëmet e shkaktuara nga administratorët e saj?
2. Në rast të shkaktimit të dëmit a do të përgjigjeshin administratorët përballë shoqërisë?
3. Cilat praktika ndeshen në krijimin e marrëdhënies së organeve administrator-shoqëri?
4. Mardhënia administrator – shoqëri është një mardhënie punë apo e një natyre të vecantë?
5. Cilat janë kriteret që duhet të respektojë gjykata në zgjidhjen e pasojave financiare në rastë të largimit/shkarkimit të administratorit nga asambleja?

b). Literaturë dhe jurisprudenca.

- Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën europiane - Thoms Bachner, Edmund-Philipp Schuster and Martin Ëinner.
- Vendimi nr. 8811, datë 29.7.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 10182, datë 13.12.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 310, datë 9.6.2011 i Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 20 U 12/06, datë 30.5.2007 i Gjykatës së Apelit të Shtutgartit, Gjermani.
- Vendimi i Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë nr. 11 4091409, datë 11.5.2009.
- Vendimi i Gjykatës së Kasacionit të Republikës Franceze, 13.12.1994, 93-11569.
- Vendimi nr. 10036, datë 8.10.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimin nr. 487, datë 4.3.2003 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 3417, datë 21.3.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 4251, datë 23.5.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 10542, datë 11.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Tiranë.
- Vendimi nr. 825, datë 8.2.2017 i Gjykatës së Rrethit Tiranë.
- Vendimi nr. 501, datë 9.10.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 359, datë 16.7.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 157, datë 17.4.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 10813, datë 18.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Tiranë.
- Vendimi nr. 10542, datë 11.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Tiranë.

c). Rast praktik 1.

Me cilësinë e administratorit personi A, në shoqërinë aksionere YY, është emëruar në këtë detyrë nga këshilli mbikëqyrës. Në vendimin e emërimit është përcaktuar një shpërblim vjetor, në këtë mënyrë: A-ja do të marrë një shpërblim bazë prej 2000 euro në muaj dhe do të shpërblehet në rast të rezultatit pozitiv të shoqërisë. A-ja shkarkohet në vitin e dytë të drejtimit të shoqërisë. Ndërkohë rezulton se ka marrë vetëm pagën, po jo shpërblimin mbi të. Provohet gjithashtu se shoqëria ka dalë me rezultat financiar pozitiv. Shoqëria YY refuzon t'i japë shpërblimin A-së.

Pyetjet që shtrohen për zgjidhje :

1. Ndërtoni ndërgjyqësinë, objektin e padisë, bazën ligjore të saj.
2. Si do të bëhet përllogaritja e shpërblimit financiar.

Tema 7 : **Falimenti. (5 *orë)***

A. Përmbajtja

Në këtë temë trajtohet çështjet e mëposhtme:

Në 2 orët e para të kësaj teme (nëntema 1) do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me qëllimin dhe synimet e procedurës së falimentimit si dhe pritshmëritë prej saj për debitorin dhe kreditorët. Më tej, do të vijohet me parimet që udhëheqin procedurën e falimentimit: Parimi i trajtimit të barabartë dhe i barazisë, Parimi i efektivitetit ekonomik, Parimi i zbatimit të procedurës gjyqësore, Parimi i legjislacionit të zbatueshëm, Parimi i shpejtësisë, Parimi i transparencës dhe i informimit.

Në këtë temë do të ndalohet edhe në aktorët kryesorë të procedurës së falimentimit, duke evidentuar përkufizimet që ligji i falimentimit jep për secilin prej tyre. Në mënyrë të vecantë do të analizohet roli dhe vendi që zë debitori në procedurën e falimentimit, si dhe roli dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit

Në 3 orët e dyta të kësaj teme (nëntema 2), do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me : Hapja e procedurës së falimentimit. Roli i Gjykatës së Falimentimit në mbikqyrjen dhe realizimin e Procedurës së Riorganizimit: krijimi i planit, miratimi i planit të riorganizimit, mbikqyrja e zbatimit;Kuptimi i riorganizimit të përshpejtuar dhe dobitë e tij; Shkarkimi nga detyrimet si një procedurë falimentimi e posaçme për individët. Roli i gjykatës në monitorimin e Administratorëve të falimentimit, dhe vendimeve të kreditorëve.Kjo temë do të përqëndrohet në shpjegimin e organeve të falimentimit: administratorët e falimentimit, etj.

B. Objektivat mësimorë të temës 7.

Për të arritur objektivat kryesorë të Kursit (shih 3.1. & 3.2 Objektivat dhe Kompetencat), kjo temë synon të arrijë objektivat mësimorë konkretë të listuara më poshtë:

Njohuri : a). Në përfundim të zhvillimit të temës kandidati për ndihmës ligjore :
-ka njohuri të thelluara dhe kuptim të qartë për çështjet që lidhen me natyrën juridike të procedurave të falimentit.
-klasifikon dhe krahason burimet e së drejtës/ autoritetet që zbatohen në praktikën gjyqësore lidhur me çështjet tregtare që lidhen me këtë institut;
-identifikon dhe analizon rastet gjyqësore të falimentit;
-është i aftë për të zbatuar standardet ligjore dhe ato statutore në raste praktike.
Aftësi : b) Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati:
-ka aftësi për të analizuar në mënyrë kritike standartet gjyqësore të çështjeve të falimentit.
-është i aftë për të arsyetuar dhe arritur në përfundime të qarta/plota/konçize për çështje ligjore dhe statutore;
-është i aftë për të arsyetuar dhe zgjidhur çështje me natyrë tregtare në mënyrë bindëse;
-është i aftë për të krahasuar, zhvilluar, argumentuar dhe interpretuar çështje të falimentit sipas standarteve të jursispudencës së vendit dhe asaj europiane.
Qëndrime : c) Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati për dihmës ligjore :
-është i vetëdijshëm për rolin dhe funksionin e tij nga prespektiva ligjore dhe sociale;
-demonstron aftësi për të krahasuar institutin e falimentit;
-është i aftë për të vlerësuar pasojat për palët;

-është i hapur për të ndryshuar qëndrimet e tij nga prespektiva e zhvillimit të praktiës së falimentit .

Aftësi joligjore : d). Në përfundim të zhvillimit të modulit kandidati për ndihmës ligjor:

-është në gjendje të përmbledhë në mënyrë të saktë dhe të bëjë pyetje për të kontrolluar kufijtë e kuptimit të çështjes;

-të shprehet qartë dhe saktë, me një gjuhë të përshtatshme dhe të kuptueshme për palët;

-të dëgjojë, reagojë dhe komentojë në mënyrë efektive e konstruktive idetë e shprehura nga kolegët,

-të mbrojë pikëpamjen e tij/saj me vendosmëri dhe, kur është e nevojshme, të heqë dorë prej saj.

C. Plani mësimor dhe metodologjia

KURSI: Gjykime të Specilazuara – Moduli e Drejta Tregtare dhe Kompanive **TEMA 7:** **JAVA:** **OBJEKTIVAT MËSIMORË (OM):** Referohu OM **PEDAGOGËT:** **Vangjel Kosta**				
Plani mësimor- Tema 7: Falimenti.				
ORARI (2 x 50 min)		**AKTIVITETI MËSIMOR**	**METODOLOGJIA**	**SHËNIME**
ORA I	- 20 min - 30	- prezantim/sqarim i çështjeve që lidhen me Natyrën edhe procedurat e falimentit. -dosje gjyqësore/rast praktik	- prezantim në pp - punë në grupe (3-4 grupe)	
	10 Minuta	Pushim		
ORA II	- 20 min - 15 min - 15 min	- diskutim i rastit praktik - pyetje-përgjigjje - përmbledhje	- secili grup prezanton 5-6 min - pyetje për secilin grup - përmbledhje- evidentimi i pikave kryesore	
ORA III	- 20 min - 30	- prezantim/sqarim i çështjeve që lidhen me Kërkesat/Paditë gjyqësore që lidhen me hapjen e procedurës së falimentit dhe zgjdhja e pasojave përkatëse.	- prezantim në pp - punë në grupe (3-4 grupe)	

		-dosje gjyqësore/rast praktik		
	10 Minuta	Pushim		
ORA IV	- 20 min - 15 min - 15 min	- diskutim i rastit praktik - pyetje-përgjigjje - përmbledhje	- secili grup prezanton 5-6 min - pyetje për secilin grup - përmbledhje- evidentimi i pikave kryesore	

ORA V	- 20 min - 15 min - 15 min	- diskutim i rastit praktik - pyetje-përgjigjje - përmbledhje	- secili grup prezanton 5-6 min - pyetje për secilin grup - përmbledhje- evidentimi i pikave kryesore	

D. Pyetje vetëstudimore, literaturë, jurisprudenca & raste praktike

a). Pyetje vetëstudimore.

-Si e kuptoni konceptin, "zgjidhje e marëdhënieve të borxhit"; si e kuptoni "falimentimin si një zgjidhje kolektive e marëdhënieve të debitorit me kreditorët";
-Si kuptohet koncepti i "debitorit të ndershëm";
-Si ndikojnë ligjet e tjera, KPrCivile, Kodi Civil, KPrAdministrative, Kodi i Punës në interferimin e tyre me Ligjin e Falimentimit;
-Çfarë natyre ka Ligji Falimentimit, procedurial, material apo të miksuar;
-Si i kuptoni parimet e , "qëndrueshmërisë së tregut", të " unitetit", të "efiçencës";
-Si e kuptoni subjektin e falimentimit "person fizik", a ka dallime personi fizik i regjistruar si tregtar nga personi fizik "konsumator";
-Cilët janë subjektet tregtarë që nuk mund të jenë pjesë e procedurës së falimentimit për shkak se falimentimi i tyre rregullohet me ligje të posaçme;
-Si kuptohet "paaftësia paguese", a ka dallim nga koncepti i " mbingarkesës me borxhe";
-Cilët janë aktorët e procedurës së falimentimit;
-Cili është raporti i AKF me GJF si aktorët më të rëndësishëm të procedurës së falimentimit;
-Si e kuptoni dallimin e rolit të Gjykatës së Falimentimit si monitoruese dhe përkujdesëse e respektimit të Ligjit të Falimentimit nga aktorët e tjerë të procedurës, si ndryshon ky rol nga roli tradicional i gjykatës si organ shtetëror që zgjidh mosmarëveshjet ndërmjet palëve;
-Si kuptohet termi "qendra kryesore e interesit", si ndikon aktiviteti tregtar në këtë concept, po regjistrimi selisë së tregtarit, po "vëndi në të cilin meren shumica e vendimeve tregtare";
-A mund të vendosë gjykata e falimentimit detyrime për palë të treta që nuk janë pjesë e procedurës së falimentumit;
-Si ndikon Ligji Falimentimit në kontratat e punës;
-A e pezullon gjykimi administrative një procedurë falimentimi nëse subjekti për të cilin kërkohet fillimi procedurës së falimentimit ushtron aktivitet tregtar në një sector strategjik të monitoruar me rregullator licencues;
-Si ndikojnë ankimet në ecurinë e procedurës, a pezullon apelimi vendimet e GJF;

-Në cilat raste njoftimet publike kanë vlerën e prezumimit të marjes dijeni për procesin;
-A është kjo kategoti çështjesh, për shkak të specifikave, me procedurë"mbi akte" në gjykimin në apel;
-Cilët janë subjektet që mund të iniciojnë fillimin e një procedure falimentimi;
-Cili është shkaku për legjitimimin e një kërkese për fillimin e një procedure falimentimi, si kuptohet specifika që debitori legjitimohet të konsiderojë shkak falimentimi edhe " paaftësinë paguese në të ardhmen e afërt";
-kush e përfaqëson debitorin në paraqitjen e kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit;,
-Cilat janë specifikat kur debitori përfaqësohet nga më shumë se një subjekt (shoqëritë e thjeshta);
-Cilët janë dokumentat kryesorë që duhet të depozitojë debitori për "të bindur gjykatën" për ekzistencën e shkakut të falimentimit;
-Cilat janë pasojat nëse debitori në paaftësi paguese nuk kërkon fillimin e procedurës;
-Si "matet" dëmi që lidhet me vonesën e fillimit të procedurës;
-Cilat janë kriteret mbi të cilat GJF do të vlerësojë ekzistencën e "paaftësisë paguese" në kushtet që gjykimi zhvillohet mbi akte, pra në pamundësi për të thirrur një ekspert për të ndihmuar të kuptojë më mirë dokumentat financiarë;
-Cilat janë kushtet ligjore që të legjitimojnë një kreditor për të kërkuar fillimin e procedurës së falimentimit;
-A është mungesa e vullnetit të debitorit për të përmbushur një detyrim në procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm vullnetar shkak për fillimin e procedurës së falimentimit;
-Cilët janë çështjet e domosdoshme për të cilat duhet të shprehet një vendim për fillimin e procedurës së falimentimit;
-Cilët janë njoftimet " e detyrueshme" të vendimit për fillimin e procedurës së falimentimit;
-Cilët janë subjektet të legjitimuar për të ankuar një vendim për fillimin e procedurës, po nëse vendoset refuzimi (rrëzimi i kërkesës);
-Cilët janë pasojat për veprimet e kryera nga administratori pas fillimit të procedurës, në rast se, gjykata e apelit prish vendimin e fillimit duke vlerësuar mungesën e ekzistencës së kushteve për fillimin e procedurës së falimentimit;
-Çfarë veprimesh duhet të kryejë GJF nëse konstaton se pasuria e debitorit nuk mund të mbulojë shpenzimet për procedurën e falimentimit;
-Cilat janë masat tipike "të përkohshme" dhe cilat janë masa specifike që lidhen me një procedurë falimentimi (shprehur nga Ligji "masa të tjera që gjykata e falimentimit i konsideron të nevojshme për të shmangur dëmtime të situatës ekonomike /financiare të debitorit në dëm të kreditorëve");
-Cila është pasoja nëse debitori, pasi është kufizuar në disponimin e pasurive nga GJF me masa të përkohshme, kryen një transaksion mbi këto pasuri;
-Cilat janë dallimet ndërmjet administratorit të përkohshëm në formën e masës së përkohshme, nga administrator përkohshëm si mbikqyrës i debitorit në vetadministrim dhe ekspertit të caktuar nga gjykata në verifikimin e kushteve për fillimin e procedurës së falimentimit;
-Cilat janë pasojat e fillimit të procedurës së falimentimit në raport me debitorin, administrimin e pasurisë, në jetën private (posta, lëvizja), në detyrimet në bashkëpunim me aktorët e tjerë të procedurës së falimentimit;
-Si ndikon fillimi procedurës së falimentimit në vijimësinë e kontratave të lidhura nga debitori, roli i administratorit/ administratorit mbikqyrës në këtë process;
-Kuptimi i falimentimit si një procedurë me synim "zgjidhje e marëdhënieve të borxhit në mënyrë kolektive"
-Dallimi i "debitorit të ndershëm" nga veprimet kriminale të debitorit (mashtrimi në falimentim);

-Ndërthurja e Ligjit të Falimentimit me ligjet e tjera, KPrCivile, Kodi Civil, KPrAdministrative, Kodi i Punës;
-Si kuptohet koncepti se, Ligji Falimentimit ka natyrë unitare dhe të përzier, procedurial dhe material njëkohësisht;
-Rëndësia e kuptimit të drejtë të parimeve më të rëndësishme që udhëheqin parimet e procedurës së falimentimit, "qëndrueshmëria e tregut" , " unitetit" dhe "efiçencës";
-Kuptim i drejtë i subjektit të e falimentimit "person fizik" qoftë në formën e personit fizik të regjistruar si tregtar dhe personi fizik "konsumator";
-Subjektet tregtarë që nuk mund të jenë pjesë e procedurës së falimentimit për shkak se falimentimi i tyre rregullohet me ligje të posaçme;
-Kuptim i drejtë i konceptit të "paaftësia paguese" dhe sqarimi se, edhe " mbingarkesa me borxhe" përfaqëson një element alternative të "paaftësisë paguese" (përveç kuptimit të drejtëpërdrejtë si pamundësi për të shlyer detyrimet e maturuara);
-Aktorët e procedurës së falimentimit;
-Roli veçanërisht i rëndësishëm i AKF me GJF si aktorët kryesorë të procedurës së falimentimit;
-Dallimi ndërmjet rolit të Gjykatës së Falimentimit si monitoruese dhe përkujdesëse e respektimit të Ligjit të Falimentimit nga aktorët e tjerë të procedurës, nga roli tradicional i gjykatës si organ shtetëror që zgjidh mosmarëveshjet ndërmjet palëve;
-Kriteret mbi të cilët përcaktohet termi "qendra kryesore e interesit" si moment vendimtar për të përcaktuar kompetencën teritoriale. Ndikimi i aktivitetit tregtar, regjistrimit të selisë së tregtarit dhe "vëndit në të cilin meret shumica e vendimeve tregtare";
-Ndikimi i Ligjit të Falimentimit në kontratat e punës, konsiderimi i fillimit të procedurës së falimentimit si "shkak i arësyeshëm" për të riorganizuar marrëdhëniet me punëmarrësit;
-Si rregull procedura e falimentimit nuk ndikohet (nuk pezullohet) për shkak të ankimeve ndaj vendimeve të GJF;
-Përveç palëve të thirrur individualisht në një procedurë nga ana e GJF, pjesmarrësit e tjerë prezumohen se kanë marë dijeni për procedurën e falimentimit nëpërmjet njoftimeve publike;
-Procedura e gjykimit në gjykatën e apelit, pavarësisht se nuk ka një dispozitë konkrete në procedurën civile, rregulli përgjithshëm për gjykatën e falimentimit- gjykimi mbi akte është i aplikueshëm edhe për gjykatën e apelit- e cila në këto raste konsiderohet " gjykatë falimentimi;

-Subjektet që mund të iniciojnë fillimin e një procedure falimentimi;
-Shkaku për legjitimimin e një kërkese për fillimin e një procedure falimentimi, specifikat e legjitimimit të debitorit të konsiderojë shkak falimentimi edhe " paaftësinë paguese në të ardhmen e afërt";
-Përfaqësimi debitorit në paraqitjen e kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit;,
-Specifikat kur debitori përfaqësohet nga më shumë se një subjekt (shoqëritë e thjeshta) –detyrimi GJF të "dëgjojë" të gjithë anëtarët e shoqërisë së thjeshtë;
-Dokumentat kryesorë që duhet të depozitojë debitori për "të bindur gjykatën" për ekzistencën e shkakut të falimentimit të cilat paraqesin, raport që duhet të evidentojë dhe provojë "paaftësinë paguese të debitorit";
-Pasojat nëse debitori në paaftësi paguese nuk kërkon fillimin e procedures në afatin 60 ditor nga momenti i ekzistencës së kushteve të "paaftësisë paguese" ose momentit që prezumohet dijenia;
-"Dëmi" që lidhet me vonesën e fillimit të procedures nuk duhet njësuar me detyrimet e debitorit, por diferenca në msasën e falimentimit për shkak të vonesës;

-“Vështirësitë” për GJF që të vlerësojë ekzistencën e “paaftësisë paguese” në kushtet që gjykimi zhvillohet mbi akte, pra në pamundësi për të thirrur një ekspert për të ndihmuar të kuptojë më mirë dokumentat financiarë- mer rëndësi verifikimi “raportit të debitorit” si dhe fakti që vlerësimi GJF është i sipërfaqshëm;
-Legjitimimi i kreditorit për të kërkuar fillimin e procedurës së falimentimit (kalimi afatit të ekzekutimit vullnetar në një procedurë ekzekutimi individual të detyrueshëm);
-Mungesa e vullnetit të debitorit për të përmbushur një detyrim në procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm vullnetar nuk mund të përbëjë shkak për fillimin e procedurës së falimentimit;
-Çështjet e domosdoshme për të cilat duhet të shprehet një vendim për fillimin e procedurës së falimentimit;
-Njoftimet “ e detyrueshme” të vendimit për fillimin e procedurës së falimentimit;
-Subjektet të legjitimuar për të ankuar një vendim për fillimin e procedurës, kërkuesi dhe subjektet e tjerë pjesmarrës në process (psh, kërkesë e kreditorit, thirret detyrimisht debitori, por mund të jetë bërë pjesë e procedurës edhe kreditorë të tjerë që mund të kërkojnë të bëhen pjesë e procedurës); nëse vendoset refuzimi (rrëzimi i kërkesës) subjekti që ka paraqitur kërkesën;
-Pasojat për veprimet e kryera nga administratori pas fillimit të procedurës, në rast se, gjykata e apelit prish vendimin e fillimit duke vlerësuar mungesën e ekzistencës së kushteve për fillimin e procedurës së falimentimit;
-Veprimet që duhet të kryejë GJF nëse konstaton se pasuria e debitorit nuk mund të mbulojë shpenzimet për procedurën e falimentimit e rëndësishme- publikimi me mundësi kontrollit paraprak të veprimeve të debitorit që mund të kenë dëmtuar masën e falimentimit;
-Masat tipike “të përkohshme” dhe cilat janë masa specifike që lidhen me një procedurë falimentimi (shprehur nga Ligji “masa të tjera që gjykata e falimentimit i konsideron të nevojshme për të shmangur dëmtime të situatës ekonomike /financiare të debitorit në dëm të kreditorëve”);
-Pasoja nëse debitori, pasi është kufizuar në disponimin e pasurive nga GJF me masa të përkohshme, kryen një transaksion mbi këto pasuri (lidhet edhe me nenin 92 “a” Kodi Civil);
-Dallimet ndërmjet administratorit të përkohshëm në formën e masës së përkohshme, nga administrator përkohshëm si mbikqyrës i debitorit në vetadministrim dhe ekspertit të caktuar nga gjykata në verifikimin e kushteve për fillimin e procedurës së falimentimit;
-Pasojat e fillimit të procedurës së falimentimit në raport me debitorin, administrimin e pasurisë, në jetën private (posta, lëvizja), në detyrimet në bashkëpunim me aktorët e tjerë të procedurës së falimentimit;
-Ndikimi i fillimit procedurës së falimentimit në vijimësinë e kontratave të lidhura nga debitori, roli i administratorit/ administratorit mbikqyrës në këtë process; Roli i administratorit/ administratorit mbikqyrës, pavlefshmëria e klauzolave që konsiderojnë fillimin e procedurës së falimentimit si shkak për zgjidhjen automatike të kontratës;
-Specifikat për kontratën e qirasë, ndarja e detyrimit para fillimit të procedurës (kreditor falimentimi) me detyrimin që lind pas fillimit të procedurës (shpenzim i procedurës).
Cilat janë kritere ligjore të përgjithshme dhe cilat janë kriteret e posaçme;
-Cili është organi kompetent për të zgjedhur administratorin e falimentimit, nëpërmjet cilëve kritere do të bëjë këtë përzgjedhje konkrete;
-Cilat janë diferencat e monitorimit të administratorit të falimentimit nga GJF dhe nga AKF;
-Si përcaktohet përgjegjësia civile, administrative/disiplinire e administratorit të falimentimit, cili është organi përgjegjës për këto përgjegjësi, kush legjitimohet të iniciojë një procedurë të tillë përgjegjësie;

-Cilat janë veprimet e administratorit të falimentimit në administrimin e masës së falimentimit për të cilat kërkohet në mënyrë të detyrueshme konsultimi paraprak me komitetin e kreditorëve dhe pëlqimi kushtëzues i GJF;
-Në cilat raste mbledhja e kreditorëve thirret dhe drejtohet nga administratori i falimentimit, në cilat raste thirrja dhe drejtimi është eksluzivitet i GJF, në cilat raste GJF mund t'a delegojë thirrjen dhe drejtimin;
-Cilat janë kriteret ligjore në caktimin e shpërblimit të administratorit, kush përcakton shpërblimin, si ndikon performanca e administratorit në ecurinë e procedurës së falimentimit në caktimin e shpërblimit;
-A është e detyrueshme për kreditorin e falimentimit një kërkesë e një kreditori/ grup kreditorësh, komitetit te kreditoreve për të iniciuar administratori një procedurë ligjore për anullimin e një veprimi të debitorit i konsideruar prej pretenduesve "i dëmshëm për interesat e kreditorëve";
-A ka të drejtë një kreditor të cilit i është refuzuar nga administratori iniciimi i një procedure ligjore anullimi të fillojë vetë një procedurë të tillë, në cilat kushte;
-Sqaroni të përbashkëtat dhe dallimet e padisë "paulania" (për kundërshtimin e veprimeve juridike të debitorit – neni) me paditë e administratorit/ kreditorit të refuzuar për kundërshtimin e veprimeve të dëmshme të debitorit;
-Cilat janë interesat e kufizueshme të kreditorëve të siguruar, në masat e përkohshme dhe pas fillimit të procedurës së falimentimit, si kompensohen dëmet e interesave të këtyre kreditorëve për shkak të kufizimit të të drejtave të tyre;
-Cili është roli i komitetit të kreditorëve dhe i mbledhjes së kreditorëve në mbarëvajtjen e procedurës së falimentimit;
-Cila është procedura e verifikimit të pretendimeve të kreditorëve, cili është roli i administratorit të falimentimit, i GJF, cilat janë elementët që e bejnë këtë procedurë të shpejtë dhe efektive;

-Kriterete përgjithshme dhe specifike për t'u përzgjedhur administrator falimentimi/ administrator mbikqyrës;
-Organi kompetent për të mbikqyrur aktivitetin professional të administratorit të falimentimit/ administratorit mbikqyrës;
-Vlerësimi mbikqyrjes së veprimtarisë së administratorit nga AKF dhe nga gjykata, pikat e përbashkëta dhe të veçanta të këtyre kompetencave;
-Përgjegjësia civile e administratorit të falimentimit; Legjitimimi për të kërkuar këtë përgjegjësi, procedura e kërkimit;
-Përgjegjësitë disiplinore-administrative të administratorit, legjitimiteti i procedurës, organi kompetent për ushtrimin e masave;
-Përgjegjësitë, procedura, kriteret që duhet të ndjekkë administrator i falimentimit në rastet e nevojës për financime të "reja" të debitorit pas fillimit të procedurës së falimentimit;
-Veprimet e administratorit të falimentimit për të cilat është kushtëzues pëlqimi i komitetit/ mbledhjes së kreditorëve dhe GJF;
-Ndarja dhe kategorizimi i mbledhjeve të kreditorëve të cilat thirren dhe drejtohen nga administrator nga mbledhjet e thirrura dhe drejtuar detyrimisht nga GJF;
-Shpërblimi i administratorit; kriteret ligjore dhe ndikimi i rezultateve në administrimin e masës së falimentimit në caktimin e shpërblimit nga GJF;
-Detyrat e administratorit të falimentimit për kundërshtimin e veprimeve të mëparshme të debitorit të cilat klasifikohen të dëmshme për interest e kreditorëve; zgjidhja e mosmarrëveshjeve të

administratorit me ndonjë pretendim të kreditorëve që kërkojnë anullimin e një veprimi të caktuar të debitorit, prezumimet ligjore të "keqbesimit" dhe mundësia e rrëzimit të prezumimit;
-Si klasifikohen grupet e kreditorëve nga Ligji Falimentimit;
-Ndarja e kreditorëve në kreditorë falimentimi dhe kreditorë të procedurës së falimentimit;
-Shpenzimet e administrimit nga administrator i falimentimit të cilat "prodhojnë" kreditorë të procedurës, përgjegjësia e administratorit në mirëadministrimin e këtyre shpenzimeve;
-Specifikat e marëdhënieve të kreditorëve të siguruar me procedurën e falimentimit dhe masën e falimentimit; kufizimet e interesave të tyre në masat e përkohshme, e drejta e "ndarjes-veçimit", kufizimi i përdorimit të kësaj të drejte, pasojat kur zbatohet kufizimi, shitja e pasurisë me të drejta sigurimi dhe të drejtat e kreditorit të siguruar në këtë procedurë shitje;
-Specifikat e kreditorëve të preferuar dhe dallimet nga preferimet e parashikuara nga Kodi Civil;
-Koncepti i kreditorëve fundorë si mundësi për të kuptuar kategorinë e "kreditorëve të pasiguruar", kufizimet e kreditorëve fundorë në vendimarrjet kolektive të kreditorëve për çështje të rëndësishme të procedurës së falimentimit;
-Roli i Komitetit të kreditorëve, zgjedhja, kompetencat, roli në monitorimin e veprimtarisë së administratorit të falimentimit;
-Rëndësia e mbledhjes së kreditorëve në procedurën kolektive të falimentimit, rëndësia vendimtare e kësaj mbledhje në perspektivën e aktivitetit tregtar të debitorit;
-Procedurat e verifikimit të pretendimeve të kreditorëve, procedura kryesisht shkresore, efiçenca e procedurës, barra e provës sipas dokumentave që mbështetin pretendimin;
-Rëndësia e administratorit në mirëorganizimin e Listës së Kreditorëve dhe rëndësia e kësaj liste për vijimësinë e procedurës së falimentimit;
-Roli GJF në verifikimin e pretendimeve, e drejta e ankimit, rëndësia e shpejtësisë së procedurës së verifikimit për një procedurë falimentimi të kujdesshme;
-Pasojat e vonesës së paraqitjes së pretendimeve.

b). Literature dhe Jurispudencë.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr.110/2016 datë 27.10.2016 " Për falimentimin"
- Vendim KM nr.542, datë 19.09.2018, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit",
- Aktet nënligjore të dala në zbatim të Ligjit nr.110/2016 datë 27.10.2016 " Për falimentimin"
- Recommendations, Commission Recommendation, of 12 March 2014 on a neë approach to business failure and insolvency
- Council regulation (EC) No 1346/2000 of 29 May 2000 on insolvency proceedings,

Vendime gjyqësore;
- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, nr. 00-2011-850 (142), datë 15.3.2012.
- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, nr. 00-2013-2304 (571), datë 18.10.2013.
- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, nr. 00-2014-1987 (324), datë 4.6.2014.
-Kolegji Civil, Nr. 43000-02552-00-2016 i Regj. Themeltar, Nr. 00-2023-3497 i Vendimit (520), datë 20.09.2023;
(Faqja Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë- rubrika "njoftime të tjera");
-NR. 8762 AKTI,dt Rregjistrimi 02.08.2023, Vendim datë 04.03.2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

-Nr: 16885 Regj. Themeltar, Vendim datë 17.10.2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
-Numri i regjistrit themeltar 8464, data e rregjistrimit 28.08.2024, Vendim datë 15.01.2025 , Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

Faqja Agjendia Kombëtare e Falimentitmit;
- VENDIM Nr. 6660, datë 5.4.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
-VENDIM Nr. 6659, datë 5.7.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
-VENDIM Nr. (11-2021-8472) 1721, datë 24.12.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës;
-VENDIM Nr. 143, datë 20.10.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës;
-VENDIM Nr. 160, datë 8.6.2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
- Manuali "Mbi ligjin shqiptar për falimentimin", Ronald C.C. Cuming (autor)
- Manuali "Falimentimi ne Aspektin Krahasues", Tirane 2005. Autore: Prof. Paul Torremans, Florina Tegu, Ardjana Shehi
- "Riorganizimi, një shans i dytë për falimentimin", Alba Skëndaj (Kand. për "Dr."), Genc Alimehmeti (PhD.), Sllavka Kurti (Kand. për "Dr.")
- Si do të falimentohet me ligjin e ri? Botim i "Deloitte Albania", Autorë; Elona Bedalli, Av. Ardjana Shehi, Av.Sabina Lalaj, "Deloitte Albania"
- "Profile penale në fushën e të drejtës falimentare", Av. Dr. Enida Bozheku, Revista Nr.28 "AVOKATIA"
- Relacion për Projekt ligjin "Për falimentimin", (Ministri Ylli Manjani)
https://ëëë.monitor.al/si-te-falimentohet-ligjin-e-ri/

http://avokatia.al/revista/14-avokatia-28/38-penale-28

https://ëëë.europeanlaëinstitute.eu/projects-publications/completed-projects-old/insolvency/

http://vietnamlaëmagazine.vn/stay-of-proceedings-and-execution-on-insolvency-procedures-5211.html

c). Dosje gjyqësore & Ratse praktike.
Rast praktik nr. 1;Shoqëria tregtare e formës shpk "Beta" ushtron aktivitet të përgjithshëm tregtar.Shoqëria është regjistruar në QKB me seli në qytetin e Tiranës. Në vitin 2018, për arësye tregtare, shoqëria ndërton një magazinë në qytetin e Durrësit dhe hap një NIPT sekondar në këtë qytet. Aktiviteti tregëtar kryesor (në kuptim të shitjeve) tanimë është në qytetin e Durrësit.
Shoqëria tregtare "Zeta" është kreditore me titull ekzekutiv, të konfirmuar nga gjykata me Urdhër Ekzekutiv ndaj shoqërisë "Beta".
Me kalimin e afatit të ekzekutimit vullnetar në procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm, më datë 10.10.2019 shoqëria "Zeta" ka depozituar kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë "Beta" në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë. Kërkesa arësyeton, në pjesën e legjitimimit të kompetencës tokësore (territorial), faktin që shoqëria "Beta" ka të regjistruar në QKB selinë e saj në qytetin e Tiranës.
Më datë 24.10.2019, shoqëria "Beta", e njoftuar ndërkohë për depozitimin e një kërkese për fillimin e procedurës së falimentimit ndaj saj, depoziton në gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës, kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit, kërkesë e paraqitur nga vetë debitori.

Në argumentat e kompetencës tokësore ajo parashtron faktin se në këtë qytet (Durrës) ka "qendrën kryesore të aktivitetit tregtar (të cilin e interpreton si qendër kryesore të interest) ". Së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit, bazuar në kërkesat e nenit 11 të Ligjit " Për falimentimin" ajo paraqet edhe provat shkresore që provojnë këtë fakt. Në kërkesë është parashtruar edhe kërkesa për bashkimin e kërkesës me kërkesën e depozituar nga kreditori "Zeta" në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, duke kërkuar që, të dyja kërkesat duhet të gjykohen në një process të vetëm, në gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës, të cilën e konsideron "gjykatën e vetme kompetente" në interpretim të nenit 11 të Ligjit.
Pyetje që shtrohen për zgjidhje :
-Cila është gjykata me kompetencën tokësore për të shqyrtuat kërkesat për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë " Beta" ?
-A janë kushtet për bashkimin e kërkesave ?
-Nëse po cila është gjykata kompetente për gjykimin e kërkesave për fillimin e procedurës të debitorit "Beta" ?

Rast praktik nr. 2;
Shoqëria "Alfa" është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.
Drejtori, duke qenë në dijeni për paaftësinë paguese të shoqërisë, kërkon thirrjen e mbledhjes së asamblesë së ortakëve duke i kërkuar pëlqimin për të kërkuar fillimin e procedurës së falimentimit ose sigurimin e alternativave për të kapërcyer gjëndjen e paaftësisë paguese. Asamblea vendos që të mos japë pëlqimin për fillimin e procedurës së falimentimit pa ofruar një alternativë konkrete për të kapërcyer gjëndjen e paaftësisë paguese.
Ndërkohë pas 8 muaj fillon procedura e falimentimit mbi kërkesën e një kreditori të legjitimuar.

Pyetjet që shtrohen për zgjidhje :
1. Mbi cilin rëndon përgjegjësia për shkaktimin e dëmeve nga mosfillimi I procedurës nga debitori në mënyrë të detyruar?
2. Cilët janë llojet dhe kufijtë e përgjegjësisë personale dhe solidare në Ligjin e Falimentit?
3. A kanë pika takimi apo kryqëzimi përgjegjësia personale dhe solidare për mospërmbushjen e detyrimeve të Kodit Civil me përgjegjësinë për mospërmbushjen e detyrimeve sipas LF?

Rast praktik nr. 3;
GjF e shpall vendimin për fillimin e procedurës së falimentimit, mbi kërkesën e kreditorit, në datë 10 prill 2021.
A-ja është caktuar si administrator dhe vijon me ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës. Ndër veprimet e tjera me masën e falimentimit, shet një magazine që e vlerëson se është e nevojshme për të krijuar likujditet për shpenzimet e procedurës (përfshirë edhe pagimin e detyrimeve të një kontrate qiraje të domosdoshme për vijimin e aktivitetit të bisnesit).
Kundër vendimit të GJF për fillimin e procedurës së falimentimit bën ankim debitori, i cili pretendon se nuk vërtetohet paaftësia e tij paguese si shkak falimentimi.
jykata e Apelit e vendos prishjen e vendimit të gjykatës së falimentimit që ka vendosur fillimin e procedurës së falimentimit dhe rrëzon kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit.

Pyetje që shtrohen për zgjidhje :

-Çfarë ndodh me veprimet që ka kryer administratori nga momenti i dhënies së vendimit të GJF?

-A do të kthehet magazina e shitur përsëri në pronësi të debitorit apo do të mbetet në pronësi të personit të tretë?

-Cilat janë mjetet juridike me të cilat mund të mbrohet debitori, psh nëse pretendon se prona është shitur nën çmimin e tregut?

Rast praktik nr. 4;
A-ja ka marrë një shumë prej 15 mijë Euro prej B-së për blerjen e një makine sipas një kontrate të lidhur më 20.03.2022;
Me lidhjen e kontratës janë paguar 2000 Euro si kapar dhe shlyerja ka vijuar deri në korrik 2022. Deri në këtë datë, A-ja ka shlyer 5500 Euro ndaj B-së
B-ja ka marrë me qira nga A-ja një ambjent për zyra me qira mujore 1000 Euro për periudhën janar 2022-dhjetor 2022. Pagesa do të bëhet me dy këste 6 mujore: 6000 Euro do të paguhen me lidhjen e kontratës dhe 6000 të tjera në fund të muajit dhjetor;
Vlera e qirave të paguara deri në filim të dhjetorit 2022 është 6000 dollarë.
Në muajin dhjetor 2022 A-ja deklaron se nuk ka mundësi shlyerje për makinën se është në kushte të një paaftësie paguese dhe ka kërkuar në gjykatë hapjen e procedurës së falimentimit në datën 11.12.2022.
B-ja i kërkon kryerjen e kompensimit për detyrimet reciproke që kanë.

Pyetje që shtrohen për zgjidhje :

1. A mund të kryhet ky kompensim?
2. A ka rëndësi fakti që është paraqitur kërkesë për hapje procedure falimentimi?
3. A ka rëndësi, nëse gjykata ka vendosur hapjen e falimentimit apo jo?
4. Analizoni nenin 71 të LF dhe spjegoni si e kuptoni shprehjen … "deri në datën kur fillon procedura e falimentimit"…?

Rast praktik nr. 5;
GjF e shpall vendimin për fillimin e procedurës së falimentimit, mbi kërkesën e kreditorit, në datë 7 prill 2019.
A-ja është caktuar si administrator dhe vijon me ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës. Ndër veprimet e tjera me masën e falimentimit, shet një magazine që e vlerëson se është e nevojshme për të krijuar likujditet për shpenzimet e procedurës (përfshirë edhe pagimin e detyrimeve të një kontrate qiraje të domosdoshme për vijimin e aktivitetit të bisnesit).
Kundër vendimit të GJF bën ankim debitori, i cili pretendon se nuk vërtetohet paaftësia e tij paguese si shkak falimentimi.
Gjykata e Apelit e vendos prishjen e vendimit të gjykatës së falimentimit që lejon fillimin e procedurës së falimentimit dhe rrëzon kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit.
Pyetje që shtrohen për zgjidhje :
1. Çfarë ndodh me veprimet që ka kryer administratori nga momenti i dhënies së vendimit të GJF?
2. A do të kthehet magazina e shitur përsëri në pronësi të debitorit apo do të mbetet në pronësi të personit të tretë?

3. Cilat janë mjetet juridike me të cilat mund të mbrohet debitori, psh nëse pretendon se prona është shitur nën kosto,?

5.VLERËSIMI I KURSIT "GJYKIMI TREGTARE DHE KOMPANIVE".

Ky seksion përmban format e vlerësimit, kriteret e vlerësimit për çdo formë vlerësimi si dhe ngarkesën mësimore.

Vlerësimi i kursit "Gjykimi Tregtar dhe Kompanive" bëhet si më poshtë :

Moduli "Gjykimi Tregtar dhe Kompanive" përbën 35 (tridhjetë e pesë) përqind të vlerësimit përfundimtar të lëndës, "Module të specializuara" në të cilën hyjnë dhe Moduli "E drejtë e mjedisit" që përbën 30 (tridhjetë) përqind të vlerësimit përfundimtar të lëndës si dhe Moduli "Kontrata civile dhe të së drejtës së punës" që përbën 35 (tridhjetë e pesë) përqind të vlerësimit përfundimtar të lëndës;

Moduli "Gjykimi Tregtar dhe Kompanive" hynë më lëndët e grupit të dytë që do të vlerësohen përgjatë gjithë zhvillimit të lëndës, bazuar në Programin e lëndës dhe përmbajnë të njëjtët elementë vlerësimi si lëndët e grupit të parë.

Vlerësimi i Modulit "Gjykimi Tregtar dhe Kompanive", do të zhvillohet në këtë formë :

a). 1 (një) vlerësim me shkrim të sekretuar sipas rregullave të shkollës, në fund të kursit. Vlerësimi me shkrim përbën 70 (shtatëdhjetë) përqind të vlerësimit përfundimtar të modulit, i cili në vetvetë përbën 35 (tridhjetë e pesë) përqind të lëndës , "Module të specializuara".
b). Vlerësimi i aftësive jo-ligjore përbën 30 (tridhjetë) përqind të vlerësimit përfundimtar të modulit, i cili në vetvetë përbën 35 (tridhjetë e pesë) përqind të lëndës, "Module të specializuara".
c) Shumatorja e dalë nga vlerësimi me shkrim dhe ai i aftësive jo-ligjore, do të mblidhet me shumatoren e dalë nga vlerësimi i dy, "Moduleve të specializuara" të tjera, përkatësisht Moduli "E drejtë e mjedisit" dhe Moduli "Kontrata civile dhe të së drejtës së punës" .

6.Ngarkesa mësimore.

Në këtë seksion jepet ngarkesa studimore. Avantazhi i paraqitjes së ngarkesës studimore në një seksion më vete është mundësia e koordinimit të të gjithë kurseve, për të parë ngarkesën totale studimore të studentëve.

Ngarkesa mësimore vjetore e Modulit "Gjykimi Tregtar dhe Kompanive" për ndihmësit ligjorë:
- do të jetë 20 orë mësimore,

Moduli "Gjykimi Tregtar dhe Kompanive" do të zhvillohet në një semestër.

Ora mësimore: 50 minuta.